



BIBLIOGRAFIA E PESË SHEKUJVE TË LIBRIT SHQIP

DR. SALI BASHOTA

Hartimi i bibliografive kombëtare, i llojeve, i tipave, i çfarësive të ndryshme, qoftë në biblioteka kombëtare apo në institute të veçanta shkencore bibliografike është një pasuri kulturore që u ofrohet, në radhë të parë, si vlerë intelektuale lexuesve të një kombi.

“Libri Shqip 1555- 1912” (*vëllimi I*) i autorit Ramazan Vozga dhe “Bib-

liografi e Librit Shqip 1913-1944” (*vëllimi II*), i autorëve Maksim Gjinaj, Margarita Mele dhe Myrvete Elmazi, gjithsesi, përbëjnë njërin ndër projektet më madhore të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe më të drejtë botimi i tyre është cilësuar ngjarje historike për gjithë botën kulturore shqiptare.

Botimi i një bibliografie të këtillë, që trajton udhëtimin e librit shqip

nëpër afër pesë shekuj është akti më i veçantë intelektual e shkencor i një biblioteke kombëtare, e cila për mision e ka ofrimin e informacionit, duke u mbështetur sipas rregullave dhe standardeve më të avancuara të përshkrimit bibliografik, duke iu referuar edhe zhvillimeve më të reja në fushën e bibliotekarisë bashkëkohore.

/ VIJON NË FAQE 8/

ORGANIZOHET EDICIONI IX I JAVËS SË BIBLIOTEKËS

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, organizojnë Edicionin e nëntë - Java e Bibliotekës në Kosovë, nga 12 deri më 16 prill 2011.

Manifestimi qendror mbahet në Prishtinë dhe në Prizren, me aktivitete të rëndësishme - ligjërata, sesione dhe debate të veçanta nga fusha e bibliotekarisë, me ekspertë-bibliotekarë nga Shqipëria dhe Kosova.

Nga bibliografia te webografia: mundësi apo realitet për bibliotekat shqiptare, Bibliotekat e Kosovës dhe informacioni; Biblioteka dhe mediat; Biblioteka dhe përdoruesit, janë disa nga temat, në të cilat do të mbahen ligjërata, sesione e debate për të parë këndvështrimet dhe rezultatet e hulumtimeve që do të japin ekspertët e fushës së bibliotekarisë.

Gjatë Javës, do të organizohet promovimi më i rëndësishëm bibliografik në historinë e kulturës shqiptare - i botuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë: *Libri shqip 1555-1912 në fondet e Bibliotekës Kombëtare*, i autorit Ramazan Vozga, si dhe *Bibliografi e librit shqip në fondet Bibliotekës Kombëtare 1913-1944*, i autorëve: Maksim Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi.

Gjatë këtij manifestimi do të bëhet prezantimi i projektit: *Portali Albanologjik Shqipëri - Kosovë*, si dhe promovimi i Trungut - *"Miq të Bibliotekës"*, me



donatorët më të rëndësishëm që kanë ndihmuar Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë do të bëhet hapja solemne e Bibliotekës së Forcës së Sigurisë së Kosovës, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë.

Me rastin e këtij manifestimi do të do të hapet Ekspozita e fotografive: "Impresione" e autorit - Fahredin Spahija, si dhe ekspozita me karikatura e autorit Ramadan Zaplluzha

Gjatë kësaj Jave, organizohet Dita e Dhurimit të Librit dhe Ekspozita e librit në gjuhën frënge në fondet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës; aktivitete në Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren me rastin e 5-Vjetorit të hapjes së Këndit Amerikan në Prizren.

Bukurije Haliti

Në këtë numër



U KRIJUA PORTALI
ALBANOLOGJIK
SHQIPËRI-KOSOVË.....4

TË PUNOJMË PËR TË BËRË
NJË KONSORCIUM TË
FORTË DHE TË QËN-
DRUESHËM NË KOSOVË.....6

456 VJET TË LIBRIT
SHQIP9

BIBLIOTEKAT NË KOSOVË
MIDIS MUNDËSIVE DHE
PASIGURISË10

BOTUESIT KUFIZOJNË KOHËN
E SHFRYTËZIMIT NË BIB-
LIOTEKË PËR E-LIBRAT12

LUMTURIA E LIBRIT.....14

VITA CON SIDERE.....18



www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Bukurije Haliti, Izet Abdyli, Muharrem Halili, Bedrije Mekolli

Fotograf: Bujar Mehmeti; **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

BIBLIOTEKA E RE E PRISHTINËS ME STRUKTURË TË NJË BIBLIOTEKE TË SË ARDHMES

VLORA DUMOSHI

Prishtina - kryeqyteti i Kosovës, me afro gjashtëqind mijë banorë, pas luftës së fundit u ballafaqua me probleme të mëdha në të gjitha fushat, sidomos në atë të infrastrukturës, e cila ishte shkatërruar nga lufta. Në këtë drejtim edhe kultura pësoi dëme të mëdha materiale dhe u desh kohë e mund për riparimin dhe krijimin e kushteve elementare për punë pothuaj në të gjitha institucionet. Vështirësitë ishin të mëdha, sepse nuk kishte mjete materiale për t'i plotësuar të gjitha këto nevoja.

Komuna e Prishtinës, në strategjinë e vet të zhvillimit të gjithmbarshëm, një ndër prioritet e saj, kishte kulturën në të gjitha dimensionet dhe shtrirjet e saj. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, në përputhje me realizimin e decentralizimit të pushtetit qendror nga viti 2010 ka marrë përgjegjësinë e plotë për të gjitha institucionet kulturore ku bën pjesë edhe biblioteka e qytetit "Hivzi Sulejmani". Strategjia e zhvillimit të kësaj drejtorie, është orientuar në mënyrë të veçantë në zhvillimin e bibliotekave, dhe atë në tri drejtime: a) në infrastrukturën ligjore (statuti, rregulloret etj.); b. në pasurimin e fondit të bibliotekës dhe ngritjen profesionale të bibliotekarëve; c. më ngritjen e infrastrukturës përkatësisht në zgjerimin e hapësirave të bibliotekës.

Zbatimi i këtyre prioritetëve është bërë në mënyrë graduale dhe të paraparë me programin zhvillimor. Dy të parat janë realizuar dhe funksionalizuar, ndërsa ajo që konsiderohet ngjarja më e rëndësishme për këtë institucion është fillimi i ndërtimit të objektit të bibliotekës në Dardani. Dihet se biblioteka e qytetit të



Maketi i bibliotekës së Prishtinës

Prishtinës nga viti 1947 funksionon në një objekt të viteve '30 dhe nuk i plotëson kushtet elementare për punë dhe aktivitet normal.

Nisur nga nevojat dhe kërkesat e mëdha që kanë qytetarët e Prishtinës për hapësira më të mëdha e më të shumta leximi, më 30 korrik 2010 është vënë gurë themeli i objektit të ri të bibliotekës "Hivzi Sulejmani". Ky objekt ka një sipërfaqe prej 4800 metra katror. Punët e ndërtimit kanë shkuar, deri tani, sipas dinamikës së paraparë përkatësisht sipas fazave.

Faza e parë që nënkupton ndërtimin (puna e vrazhdët) është kryer gjatë vitit 2010, ndërsa gjatë këtij viti (2011) po vazhdon realizimi i fazës së dytë, ku janë të inkorporuar edhe punët përfundimtare.

Me realizimin e këtij projekti, komuniteti jo vetëm bibliotekar por edhe ai artistik i Prishtinës do të kenë një objekt në të cilin do të mund të realizohen shumë veprimtari kulturore. Natyrisht se mbi të gjithë, kjo bibliotekë do të jetë në funksion të përdoruesve, të cilëve do t'u mundësohen hapësira të mjaftueshme dhe të ngritura sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekarisë.

Përdorimi i literaturës do të jetë i lehtë, duke i vënë në funksion fondet e hapura, ndërsa që ambientet e punës për lexuesit do të jenë hapësira moderne që ofrojnë rehati e përshtatje sipas fushave të kërkimit e llojeve të materialeve bibliotekare që do të përdoren, duke qenë në funksion ambiente të pajisura me teknologji informative. Në këtë drejtim po veçoj se në këtë projekt janë parashikuar tri salla ku përdoruesit mund të lexojnë dhe shfrytëzojnë literaturën e nevojshme, depoja e madhe, ku do të mund të ruhet një fond i madh i librave, salla për simpoziume, debate, konferenca dhe aktivitete shkencore nga fusha të ndryshme, si dhe salla për programe artistike (salla kamertale) me numër të kufizuar pjesëmarrësish.

Shpresojmë se ky projekt do të përfundojë së shpejti sipas afatit të planifikuar, ku qyteti i Prishtinës do të pajiset me një objekt të bukur arkitektonik mu në zemrën e Dardanisë Antike, objekt ky që do të përmbush nevojat e qytetarëve të Prishtinës, duke qenë në funksion të zhvillimit të strategjive në nivel kombëtar për funksionimin e bibliotekave sipas standardeve ndërkombëtare.

U KRIJUA PORTALI ALBANOLOGJIK SHQIPËRI-KOSOVË

Tiranë, 5 mars

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh kulturor midis institucioneve qendrore të bibliotekarisë së dy shteteve dhe duke e mbështetur në Rezolutën e Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë “Shkenca e bibliotekave dhe Albanologjia”, të mbajtur më 5 mars 2011 në Tiranë, u nënshkrua Marrëveshja për krijimin e portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë. Marrëveshja u nënshkrua nga Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në këtë ceremoni solemne ishin të pranishëm personalitete të njohura të jetës politike, kulturore e shkencore të Shqipërisë, përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës etj.

Duke folur për rëndësinë e krijimit të portalit të përbashkët albanologjik, ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ferdinand Xhaferaj, i cili ishte i pranishëm në këtë aktivitet, ndër tjera, tha se me këtë portal të përbashkët ne po krijojmë një hapësirë të unifikuar, e cila u jep mundësi përdoruesve dhe lexuesve përtej dhe këtej kufirit që të kenë qasje në burimet albanologjike.

Në aktet e Marrëveshjes synohet që të dy institucionet do të bashkëndihmojnë në informimin e përdoruesve për bazën kombëtare të të dhënave të dy bibliotekave përkatëse, si dhe të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimeve të informacionit bibliografik të karakterit



Nënshkrimi i marrëveshjes për krijimin e portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë

albanologjik, në radhë të parë, të objekteve të digjituara: dorëshkrime, antikuare, harta, fotografi, periodikë, etj.

Në këtë drejtim të dy institucionet do të nxisin implementimin e teknologjive të reja të informacionit në proceset dhe shërbimet bibliotekare, ndërsa Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do të ofrojë ndihmesën profesionale dhe shkencore për përpunimin e procesit të digjimit në Kosovë nëpërmjet organizimit të seminareve apo veprimtarive trajnuese në Tiranë dhe Prishtinë.

Gjithashtu, përmes kësaj marrëveshjeje të dy institucionet kryesore bibliotekare të dy shteteve, duke u mbështetur në kushtet e shoqërisë së informacionit dhe të teknologjive të reja, do të përshpejtojnë realizimin me sukses të detyrave funksionale që lidhen me rolin e tyre si ndërmjetëse mes dijes albanologjike dhe informacionit të pafund që bartin koleksionet gjegjëse, nga njëra anë, dhe lexuesit që i përdor ato, nga ana tjetër.

Pra, duke u mbështetur në këtë marrëveshje, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare

dhe Universitare e Kosovës do të bashkëpunojnë me epike të caktuara profesionale në krijimin e portalit të përbashkët Shqipëri - Kosovë, i cili do të ofrojë qasje në burime bibliografike: libra, artikuj, harta, dorëshkrime etj., apo burime digjitale të karakterit albanologjik.

Qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij projekti të rëndësishëm kombëtar ndërlidhen me përparësitë që mund t'i kenë të dy institucionet për të kontribuar më konkretisht në promovimin e trashëgimisë kulturore të shkruar kombëtare të dy vendeve përkatëse në portale europiane dhe botërore, përmes rrjetit botëror të informacionit.

Promovimi i portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë do të bëhet në kuadër të edicionit të nëntë të manifestimit ndërkombëtar: “Java e Bibliotekës në Kosovë”, i cili do të mbahet në Prishtinë nga 12-16 prill 2011. Kjo veprimtari organizohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe, gjithsesi, është manifestimi kryesor i vitit për bibliotekat në Kosovë.

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË (BKSh)
DHE
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS (BKUK)
PËR KRIJIMIN E PORTALIT ALBANOLOGJIK
SHQIPËRI-KOSOVË**

Dy Drejtorët, Z. Aurel Plasari në cilësinë e Drejtorit të BKSh-së (në emër të BKSh-së) dhe z. Sali Bashota në cilësinë e Drejtorit të BKUK-së (në emër të BKUK-së), në mbështetje të Marrëveshjes dypalëshe kulturore të Autoriteteve Eprore, nën të cilat BKSh dhe BKUK ushtrojnë veprimtarinë, duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar marrëdhëniet nëpërmjet bashkëpunimit si partnerë, këtu të quajtur palë, janë marrë vesh për sa më poshtë:

NYJA 1

Palët do të bashkëndihmojnë në informimin e përdoruesve për bazën kombëtare të të dhënave të dy bibliotekave përkatëse.

NYJA 2

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimeve të informacionit bibliografik të karakterit albanologjik, si dhe të objekteve të digjituara (dorëshkrime, antikuarë, harta, fotografi, periodikë, etj.).

Z. Aurel PLASARI
Drejtor
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

NYJA 3

Palët do të nxisin implementimin e teknologjive të reja të informacionit në proceset dhe shërbimet bibliotekare.

NYJA 4

BKSh do të ofrojë ndihmesën profesionale dhe shkencore për përparimin e procesit të digjimitit në Kosovë nëpërmjet organizimit të seminareve apo veprimtarive trajnuese në Tiranë apo Prishtinë.

NYJA 5

Palët, në kushtet e shoqërisë së informacionit dhe të teknologjive të reja, do të përshpejtojnë realizimin me sukses të detyrave funksionale që lidhen me rolin e tyre si ndërmjetëse mes dijes albanologjike dhe informacionit të pafund që bartin në koleksionet gjegjëse, nga njëra anë, dhe lexuesit që i përdor ato, nga ana tjetër.

NYJA 6

Palët do të bashkëndihmojnë në krijimin e një portali të përbashkët

Z. Sali BASHOTA
Drejtor
Biblioteka Kombëtare dhe
Universitare e Kosovës

Shqipëri – Kosovë, i cili do të ofrojë qasje në burime bibliografike (libra, artikuj, harta, dorëshkrime etj.) apo digjitale të karakterit albanologjik.

NYJA 7

Palët do të kontribuojnë në promovimin e trashëgimisë kulturore të shkruar kombëtare të dy vendeve përkatëse në portale europiane dhe botërore, përmes rrjetit botëror të informacionit.

NYJA 8

1. Marrëveshja nuk ka kufizime kohore.
2. Marrëveshja mund të plotësohet dhe shtjellohet më tej në mirëkuptim dypalësh.
3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim, me pëlqim të përbashkët të Palëve.

NYJA 9**Hyrja në fuqi**

Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë. Nënshkruhet në Tiranë, më 5 mars 2011, në dy kopje origjinale në shqip.

INTERVISTË ME ZNJ. RIMA KUPRYTE, DREJTORESHË E EIFL-it

TË PUNOJMË PËR NJË KONSORCIUM TË FORTË DHE TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË

Rima Kupryte është e diplomuar në Universitetin Vilnius në Lituani. Ka punuar në Fondacionin për Shoqëri të Hapur në Lituani (OSF), pjesë e rrjetit të Fondacionit Soros; në Institutin për Shoqëri të Hapur në Budapest, si menaxhere në Programin për Rrjetin e Bibliotekave.

Është drejtoreshë ekzekutive e Konsorciumit EIFL.

Më 2008, Rima Kupryte u nderua me Medaljen e IFLA-s, një nga titujt më të lartë për profesionalizëm për kontributet e saj ndërkombëtar në fushën e bibliotekës dhe informacionit.



Rima KUPRYTE

Znj Rima, si udhëheqëse e EIFL-it, a mund të na thoni, për kërkesit e burimeve elektronike në Kosovë, çfarë është EIFL dhe cilat janë objektivat e saj?

Rima KUPRYTE: EIFL është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse, që punon në bashkëpunim me bibliotekat në më shumë se 45 vende në zhvillim dhe tranzicion si në Afrikë, Azi dhe Evropë.

Misioni ynë është që të mundësojmë qasje në njohuri për edukim, mësim, hulumtim dhe zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit. Përmes 5 programeve tona, ne u krijojmë mundësi konsorciumeve që t'i përshtatin qasjet e tyre në njohuri.

Objektivat tona janë të ndërtojmë kapacitete përmes trajnimeve dhe burimeve të specializuara, të mbrojmë qasjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të inkurajojmë shkëmbimin e njohurive, zgjerimin e qasjeve të burimeve elektronike komerciale, dhe t'u mundësojmë të fitojnë projekte për shërbime të reja në biblioteka.

Programet tona janë të dizajnuara për të adresuar sfidat që bibliotekat dhe

përdoruesit e tyre përballen në mjedisin digjital. Pesë programet tona janë:

- EIFL-Licencimi: Negociojmë marrëveshje të përbalueshme dhe të paanshme të licencimit, ndihmojmë në informacionet e burimeve elektronike dhe inkurajojmë abonimin dhe përdorimin e tyre;
- EIFL-OA (Open Access): Përkrahim adaptimin dhe miratimin e politikave për Qasje të hapur (OA) si dhe ngritjen e kapaciteteve për të nisur dhe ndihmuar në krijimin e informacioneve të OA;
- EIFL-IP (E Drejta e Autorit dhe Bibliotekat): Luajmë rol kryesor në promovimin dhe reformimin e ligjit për mbrojtjen e të drejtës së autorit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mbështesim bibliotekarët që të kenë qasje të drejtë dhe të paanshme;
- EIFL-FOSS (Softuerë të Lirë dhe me Burim të Hapur): Përkrahim përdorimin e softuerëve të hapur dhe inkurajojmë bibliotekat që të mbështesin këtë rrjet në vendet partnere të EIFL;
- EIFL-PLIP (Program për Inovacione në Biblioteka Publike): ofron burime për të testuar ide të reja që përdorin teknologjinë për të përmirësuar jetën dhe jetesën në përgjithësi.

Cili është roli i konsorciumeve në EIFL, pasi që e dimë se për çdo Konsorcium të themeluar keni dhënë grante dhe keni ndihmuar themelimin e tij?

Rima KUPRYTE: EIFL nuk është një agjenci financimi, por ne jemi në gjendje për të punuar me financuesit për të siguruar grante për vendet partnere. Në mënyrë të veçantë, për disa nga vendet tona ne kemi siguruar fonde që të kujdesen për mbarëvajtjen e trajnimeve dhe kemi mbështetur ata në themelimin e konsorciumit.

Siç e dini, konsorciumi i bibliotekës është një grup i bibliotekave që punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta. Përmes anëtarëve të bibliotekave konsorciumet u ofrojnë përdoruesve shërbime në koleksionet elektronike me çmime të arsyeshme.

Në EIFL, qasja jonë unike është që bibliotekat të organizohen në Konsorciumin e Bibliotekave Kombëtare ku mund të lidhen me miliona njerëz të tjerë. Asnjë bibliotekë e vetme nuk do të mund të sigurojë cilësi të lartë të shërbimit dhe rrjet të gjerë të burimeve elektronike, të cilat mund t'u ofrohen kërkesave të përdoruesve. Konsorciumet janë model tashmë i testuar në mbarë globin, që u japin mundësinë bibliotekave për të ofruar shërbime që nuk do të mund t'i sigurojnë vetë dhe

të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira në mesin e anëtarëve të tyre.

Meqë ju thoni e EIFL është organizatë joprofitabile, çfarë shërbimesh u ofron anëtarëve të saj?

Rima KUPRYTE: Ka shumë shërbime që ne ju ofrojmë anëtarëve tanë në kuadrin e programeve që kam përmendur në paraqitjen time të EIFL-it.

Midis tyre është qasja në një gamë të gjerë të burimeve elektronike komerciale me një çmim të ulët, dhe në disa raste edhe falas. Për shembull, përmes programit-EIFL Licencimit, burimet e mëposhtme janë të disponueshme falas për anëtarët e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës: BioOne, Cambridge Journals Online, IOPscience, OECD-iLibrary, Oxford English Dictionary Online dhe Oxford Reference Online.

Aktualisht, ka 20 abonime për këto burime në pesë institucione të Kosovës. Ekziston një potencial për abonime prej 24 bibliotekave që janë anëtare të Konsorciumit. Stafi i programit EIFL-Licencimi është në dispozicion për të punuar me ju që t'ju ndihmojnë në rritjen e abonuesve dhe të përdorimit.

Gjithashtu, më poshtë po ua paraqes një link me listën e plotë të burimeve në dispozicion pa pagesë ose me çmime shumë të ulëta për anëtarët e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës në <http://www.eifl.net/eifl-licensing-kosovo>. Njëherësh ofrojmë mirëmbajtjen e ueb-faqes falas për Konsorciumin tuaj, nëse ju nuk keni akoma ueb-faqe.

Ne, gjithashtu, ofrojmë mbështetje përmes punëtorive, në ngritjen e kapaciteteve në të gjitha fushat e programeve dhe njëherësh ofrojmë këshilla përmes vizitave, si dhe sesioneve online. Ne sigurojmë burime online, në veçanti në fushat e të drejtës së autorit dhe OA, udhëzime teknike në FOSS, dhe në përgjithësi informacionet më të reja nëpërmjet adresave elektronike në seksionin e anëtarëve të faqes sonë të internetit.

Për çdo vit organizojmë Asambleenë e Përgjithshme të EIFL, në të cilën marrin pjesë të gjithë anëtarët. Ai është një

takim mjaft i suksesshëm në shkëmbim të njohurive dhe praktikave. Këtë vit Asambleja do të jetë më 26-28 qershor në Minsk, Bjellorusi. Ne inkurajojmë të gjithë anëtarët që të marrin pjesë në këtë ngjarje, e cila organizohet nga anëtarësia vjetore e secilit anëtar të EIFL-it.

Siç e thash edhe më lart, modeli ynë është që të punojmë me konsorciume, të fitojnë përvoja në krijimin dhe menaxhimin e një konsorciumi efektiv dhe të qëndrueshëm të bibliotekave.

Së fundi, duke qenë pjesë e rrjetit global EIFL, ju keni mundësinë që anëtarëve tuaj të Konsorciumit t'u përforconi vizionin e, gjithashtu, të ndihmoni personelin në ngritjen e tyre profesionale.

Përveç shërbimeve, EIFL ofron edhe trajnime në këto fusha. Çfarë mund të përfitojë një bibliotekë siç është Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, ose bibliotekat e Kosovës në përgjithësi?

Rima KUPRYTE: Përveç përfitimëve të cekura më lart, Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës do të përfitonte nga trajnimet tona dhe konsultimet në fusha të rëndësishme të bibliotekarisë, duke përfshirë menaxhimin e konsorciumit, negocimin dhe lejimin e burimeve elektronike, në qasje të hapur, në të drejtën e autorit, dhe në mjete të tjera me burime të hapura. Vitin e kaluar ne kemi nisur programin më të ri për bibliotekat publike (Public Library Innovation Program) dhe bibliotekat publike nga Kosova mund të aplikojnë për grante dhe të adresojnë nevojat për komunitetin dhe nevojën për përdorimin e teknologjive të reja. Konkursi i ardhshëm për projekte do të hapet në fund të prillit 2011, me ç'rast inkurajojmë të ndiqni faqen tonë të internetit: <http://www.eifl.net/plip/>, për të marrë informatat më të reja për mundësinë e aplikimit dhe financimit të këtyre projekteve. Ne kemi një strukturë të koordinatorëve për çdo program në secilin vend. Kjo ofron mundësi që të interesuarit të punojnë me EIFL në një fushë të veçantë, jo vetëm të zgjerojnë njohuritë e tyre për fusha të caktuara, por edhe të

shkëmbejnë kërkime shkencore me pjesën tjetër të bibliotekës dhe të komunitetit. Këtë strukturë e kemi parë të jetë shumë e suksesshme në ndërtimin e kapaciteteve për individët dhe, madje, për gjithë konsorciumin.

Koordinatorët janë të emëruar nga Konsorciumi i tyre. Për çdo vend kemi një koordinator vendi, dhe pastaj një koordinator për çdo program: licencimi (në shumë raste ky person është koordinator i vendit), qasje të hapur (OA), të drejtën e autorit (IP), dhe softuerit të lirë dhe me burim të hapur (FOSS). Koordinatorët nuk kanë nevojë të kenë njohuri në fushën e tyre, por ata duhet të jenë të motivuar vetë dhe të kenë vullnet të fortë për të mësuar më shumë.

Aktualisht në Kosovë është vetëm Bukuri Haliti që shërben në vend, për licencim, qasje të hapur dhe FOSS. Për të realizuar përfitimet që ofrohen në përgjithësi nga EIFL, ju duhet të shtoni pjesëmarrësit dhe duhet të caktoni një koordinator për të drejtën e autorit (IP).

A pritet ta vizitoni Kosovën në një të ardhme të afërt dhe si e shihni të ardhmen e Konsorciumit në një vend në tranzicion?

Rima KUPRYTE: Për vendet në tranzicion, shohim një të ardhme shumë të ndritshme të konsorciumeve. Siç kam deklaruar, ne kemi parë shumë suksese që një vend i ka arritur kur ka formuar një konsorcium, duke punuar shumë dhe së bashku në drejtim të qëllimeve të përbashkëta. Në fakt, kohët e fundit kemi vënë në pah suksesin e tri vendeve partnere të EIFL, të cilat do të festojnë 10-vjetorin e themelimit të konsorciumeve më 2011, e ato janë Lituania, Moldavia dhe Serbia. Mund të lexoni më shumë rreth tyre në <http://www.eifl.net/news/3-library-consortia-celebrating-10-successful>.

Do të donim shumë të vizitojmë Kosovën, dhe, nën udhëheqjen e Bibliotekës Kombëtare, të prezantojmë dhe debatojmë me të gjitha palët e EIFL që të marrim vendime e të punojmë për të bërë një Konsorcium të fortë dhe të qëndrueshëm atje.

Intervistoi: **BUKURIJE HALITI**

BIBLIOGRAFIA E PESË SHEKUJVE TË LIBRIT SHQIP

/ VIJON NGA BALLINA /

Botimi i bibliografisë kombëtare të librit shqip, në të cilën përfshihet një periudhë kaq e gjatë e historisë së librit, pa dyshim, është edhe një dëshmi e fuqishme e këtij informacioni të sistemuar nëpër fazat e edukimit, të kulturës dhe të identitetit të popullit shqiptar nëpër qindrvjeçarë.

Kriteret e hartimit, metoda, struktura, funksioni i saj në njërin anë, si dhe përbërësit e kërkimit, dija për librin, treguesit e emrave dhe treguesit tjerë, në anën tjetër, i japin kësaj bibliografie kombëtare dimension dhe vlerë të veçantë shkencore.

Bibliografia e Librit Shqip, në fakt, është histori e qytetërimit shqiptar. Gjithsesi, kultura burimore shqiptare do të jetë më e pasur, më e nderuar, më e çmuar me botimin e këtyre dy vëllimeve të bibliografisë.

Bibliografia e Librit Shqip do të lexohet si një kryevepër e kulturës shqiptare që e ka kohën, hapësirën, autorësinë, lexuesit e vet me një ndjeshmëri magjepsëse intelektuale për burimin e kërkuar dhe për një pasion për specialistët e fushave të caktuara.

Informacionet e sotme bibliografike për historinë e librit shqip na nxisin të mendojmë për diversitetin e shenjave shkrimore e gjuhësore nëpër etapa dhe periudha të caktuara kohore të librit shqip. Ky fenomen ndërlidhet me qytetërimin dhe identitetin e shqiptarëve, ndërsa bibliografia, *përshkrimi i librit*, e ka kuptimin dhe



interpretimin e vet edhe përbrenda kontekstit shoqëror, kulturor, social, religjioz deri te identiteti shtetëror.

Një kulturë kombëtare që e ka historinë e pasur të botimeve, që e ka bibliografinë e vet kombëtare, gjithsesi, dëshmon tërë atë kompleksitet të referencave që kanë burim kulturor, gjuhësor, letrar, filozofik, sociologjik, etnologjik, historiografik, publicistik, gjeografik etj.

Bibliografia e Librit Shqip është fenomeni më i dëshiruar i çdo biblioteke, arsytimi më i plotfuqishëm i specialistëve të saj për të ofruar, në radhë të parë, informacionin bibliografik në favor të zhvillimit dhe të perspektivës së mendimit me karakter shkencor dhe kulturor në përgjithësi.

Bibliografia e Librit Shqip e hartuar dhe realizuar nga kontributet e veçanta personale merr atribute kolektive dhe universale duke u bërë referencë burimore edhe në njohjen dhe afirmimin e kulturës shqiptare.

Duke i ndriçuar specifikat e librit shqip nëpër periudhat e historisë, kjo bibliografi do të bëhet udhërrëfyese e interpretimit kritik e historik për çdo kërkues e studiues shqiptar dhe për çdo kërkues e studiues ndërkombëtar duke artikuluar përmasën e dijes sistematike, e cila ofrohet për librin dhe kulturën shqiptare.

Bibliografia e Librit Shqip është njëri ndër projektet më të fuqishme kombëtare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë tashmë duke u bërë trashëgimi e përveçme kulturore që e ka funksionin primar të komunitetit në tërë hapësirën kulturore shqiptare.

Gjithsesi, ky informacion bibliografik me përfaqësim afër 500 vjeçar të librit shqip është një enciklopedi e llojit të vet, që e ka frymën burimore, pa dyshim, si kryevepër monumentale e kulturës shqiptare në përgjithësi.

Pra, libri shqip në pesë shekuj tashmë e ka shenjë e vet emblematike, bibliografinë kombëtare, të projektuar në kohën tonë, në këtë 90-vjetor të themelimit të institucionit më të lartë të bibliotekarisë në Shqipëri, falë punës së pakursyer dhe të vyeshme të specialistëve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë nën drejtimin e dr. Plasarit.

456 VJET TË LIBRIT SHQIP

“LIBRI SHQIP 1555-1912 NË FONDET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE BIBLIOGRAFI” DHE “BIBLIOGRAFI E LIBRIT SHQIP NË FONDET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE (1913-1944)”

MR. SC. TAHIR FONIQI

Në Tiranë, vitin e kaluar, janë botuar dy bibliografi retrospektive kombëtare, duke e pasuruar e çuar, kështu, përpara traditën e botimit të bibliografive në Shqipëri, për Shqipërinë dhe për shqiptarët, nisur nga gjysma e dytë e shekullit nëntëmbëdhjetë.

Tash mund të flitet për prurje të rëndësishme botuese bibliografike në Shqipëri, në këtë fushë specifike të dijes. Këtë trashëgimi e bëjnë edhe më të pasur vëllimet: Libri Shqip 1555-1912 (vëllimi I) dhe 1913-1944 (vëllimi II), të cilat mbulojnë një periudhë prej rreth pesë shekujsh të botimit të librit shqip e me, të drejtë, është cilësuar ngjarje historike për gjithë kulturën shqiptare. Të dy pjesët e para bibliografike përfshijnë 4393 njësi bibliografike, 1343 faqe ose 84 tabakë shtypi. Vëllimet i ka botuar Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, në 90-vjetorin e themelimit, ndërsa i ka shtypur shtypshkronja e Shtëpisë Botuese Onufri e Tiranës në format 25 x 17 cm.

“LIBRI SHQIP 1555-1912 NË FONDET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE”

Ky vëllim bibliografik përbën pjesën e parë, ndër tri pjesët e planifikuarat, për periudhën nga fillimet e librit shqip (1555) deri më 1959. Vëllimin e ka hartuar Ramazan Vozga. Bibliografia ka regjistruar 558 njësi bibliografike. Fillon me njësinë [*Meshar*] të Gjon Buzukut e përfundon me njësinë [*Dita e gjyqit*] e Pjetër Zarishit. Për hartimin kësaj bibliografie hartuesi është mbështetur në fondet e librit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ai ka zgjedhur përshkrimin gjithëpërfshirës të njërive bibliografike, duke i dhënë bibliografisë karakter shkencor. Bibliografia është hartuar mbi bazën kronologjike të viteve. Fillon me vitin 1555 e përfundon me 1912. Teksti

është hartuar sipas parimit *de visu* (drejtpërdrejt nga burimi), ku janë respektuar të gjitha zonat e përshkrimit bibliografik të njësisë bibliografike: zona e autorëve, zona e titujve të librit, zona e botimit, zona e vendit të botimit, viti, botuesi etj. Kjo bibliografi është pasuruar me treguesin e autorëve, treguesin e titujve të librave, treguesin lëndor, treguesin e botuesve, treguesin e tipografëve, libërshitësve, shtypshkronjave etj. Teksti i përket bibliografisë së përgjithshme retrospektive, përkatësisht bibliografisë anotuese.

“BIBLIOGRAFI E LIBRIT SHQIP NË FONDET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE (1913-1944)”

Këtë vëllim e kanë hartuar Maksim Gjinaj, Margarita Mele e Myrvete Elmazi. Bibliografia përfshin 3835 njësi bibliografike. Fillon me njësinë *Maksime të Massimo (D) Azeglio* e përfundon me njësinë *Mbreti Perandor Viktor Emanuel i III në Shqipëri midis entuziasmit të popullit në një britmë të vetme devocioni dhe besnikërije*.

Bibliografia është hartuar mbi bazën e botimeve në fondet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo përfshin botime të territorit të Shqipërisë në shqip dhe në gjuhë të huaj dhe botime të realizuara jashtë Shqipërisë, të autorëve shqiptarë e të huaj në gjuhën shqipe. Informacioni bibliografik përfshin: monografi, vepra letrare, antologji, botime zyrtare, botime shkollore, botime muzikore, albume etj. Në të dhënat bazë të njësisë bibliografike është ruajtur drejtshkrimi i kohës kur është botuar vepra duke u përdorur të gjitha zonat e përshkrimit bibliografik. Në raste të veçanta hasen ndërhyrjet e hartuesve të bibliografisë për saktësinë e dokumentit, merret vesh me kllapa katrore []. Lënda bibliografike është organizuar në 30 kapituj: I. Filozofi. Sociologji. Psikologji.

Etikë, II. Shkenca ekonomike, III. Partitë politike, IV. Organizata. Shoqata. Klube, V. Gjendja politike, ekonomike dhe shoqërore e Shqipërisë në vitet 1913-1944, VI. Gjendja politike, ekonomike, dhe shoqërore e vendeve të tjera në vitet 1913-1944, VII. Shteti dhe e drejta, VIII. Probleme sociale dhe demografike. Statistika e përgjithshme dhe ekonomike, IX. Puna. Kontratat, X. Financat. Kontabiliteti, XI. Ushtria, XII. Shkencat e natyrës. Matematika, XIII. Industria. Teknika, XIV. Bujqësia. Ekonomia agrare, XV. Transporti. Mjetet e transportit, XVI. Ndërlidhja. Postat. Filatelia, XVII. Tregtia. Hoteleria. Turizmi, XVIII. Punime komunale. Shërbimet e popullsisë. Ekonomia shtëpiake, XIX. Shëndetësia. Mjekësia. Kryqi i kuq Shqiptar, XX. Kultura fizike. Sporti, XXI. Kultura. Arsimi. Shkenca, XXII. Filologjia. Gjuhësia, XXIII. Letërsia artistike dhe dokumentare, XXIV. Arti, XXV. Etnokultura, XXVI. Historia. Etnogjeneza, XXVII. Biografi, XXVIII. Feja. Teologjia, XXIX. Shtypi. Libri. Bibliotekat. Gazetaria, XXX. Manuale me karakter të përgjithshëm. Enciklopedi. Harta. Pllakate. Secili grup është ndarë në nëngrupe, kushtëzuar nga lënda. Të gjithë zërat bibliografikë mbajnë numrin rendor në rritje progresive nga 1 deri në 3835. Bibliografia është pasuruar me treguesin e autorëve, treguesin e personave dhe vendeve, treguesin e titujve të librave, treguesin e vendeve të botimit dhe shtypshkrimit, treguesin e botuesve, treguesin kronologjik të botimeve, treguesin e autografëve dhe të kushtimeve dhe treguesin e vulave. Teksti i përket bibliografisë së përgjithshme retrospektive, mbështetur në rregullat e Klasifikimit Universal Decimal (KUD).

Botimi i këtyre dy bibliografive e tumir fuqishëm mendimin e Malarmes: “Bota ekziston për të dalë te një libër”.

BIBLIOTEKAT NË KOSOVË MIDIS MUNDËSIVE DHE PASIGURISË

RAMIZE BAJRAKTARI

Departamenti i Arsimit Bibliotekar vijon të monitorojë gjendjen e bibliotekave të tipave të ndryshëm, të mbledhë të dhëna, të ndërtojë një dialog intensiv me stafin e këtyre bibliotekave, për të vëzhguar gjendjen e tyre, mungesat, kërkesat dhe mundësitë e tyre të zhvillimit. Nga opinionet dhe analizat e bëra del se bibliotekat ende nuk e kanë trajtimin e duhur nga institucionet përkatëse. Ato vijnë të funksionojnë me probleme nga ato më elementare deri te ato që lidhen me nevojat e transformimit dhe modernizimit të tyre, si rezultat e kërkesave të kohës.

Shumica e bibliotekave vijnë të funksionojnë në hapësira të ngushta, me koleksione të vjetruara dhe pa mundësi sistemimi për koleksione të reja, me hapësira të papërshtatshme për përdoruesit dhe me një bazë informacionin e skedari të pakompletuar mbështetur në numrin e titujve dhe të ekzemplarëve në fondin bibliotekar.

Nga mbledhja pa kriter e materialit bibliotekar, pas luftës, ose nga zhdukja dhe shkatërrimi i fondeve gjatë luftës, nuk ka një pasqyrë të përshkrim të njëjës fazë dhe të tjetrës të zhvillimit të një biblioteke dhe as një sistematizim dhe klasifikim të fondeve që janë të vlefshme dhe duhet ruajtur si pjesë e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Bibliotekat po vuajnë pasojat e një indiference të institucioneve që kanë përgjegjësinë e përkujdesjes ndaj tyre, po aq edhe të një kurthi brenda për brenda që përcillet me mungesën e projekteve që do të përmbanin ide konkrete për politikën e pasurimit të koleksioneve, spastrimit të tyre, formave të përpunimit, si dhe formave të përdorimit të këtyre koleksioneve.

Një ndër problemet më të mëdha është mungesa e stafit të përgatitur që

do të sillej sipas dinamikave të zhvillimit dhe modernizimit të bibliotekave po aq edhe hyrjeve të reja të koleksioneve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre tjerave, të formave të përpunimit të tyre etj. Kur është fjala te pasurimi i fondeve, funksionimi i kësaj politike, kërkon koncept të qartë që lidhet me aktualitetin e koleksioneve dhe vlerën e tyre, sipas profilit të përdoruesve dhe tipit të bibliotekës. Biblioteka është institucion i motivimit të përdoruesve dhe i plotësimit të kërkesave të tyre, duke njohur mirë idenë e qarkullimi të përgjithshëm të informatave dhe materialeve.

Në këto kushte jemi para sfidave se si t'i rrisim kapacitetet për trajnimin dhe arsimin e bibliotekarëve; të fokusohemi në module të dijeve e njohurive për të cilat kemi prioritetet; të merren së paku njohuritë e domosdoshme për përpunimin e informacionit bibliografik - manual apo elektronik, në mënyrë që përdoruesit të mos vihen në vështirësi gjatë kërkimit të informacionit në bibliotekë.

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ekziston tashmë Qendra e trajnimeve e cila i ka të gjitha kushtet për realizimin e trajnimeve sipas programeve. Në këtë kontekst BKUK, ka nisur fazën e trajnimeve për bibliotekarë të bibliotekave të tipave të ndryshëm. Është duke u bërë përpjekje maksimale për të mundësuar organizimin dhe mbajtjen me sukses të trajnimeve, kurseve dhe seminareve, për ngritjen profesionale të stafit të bibliotekave. Për realizimin e këtyre trajnimeve tashmë duhet një staf i certifikuar, në mënyrë që të jetë i përgatitur për arsimimin e informimin, kohë pas kohe, të stafit të bibliotekave, duke gjurmuar e zbatuar mekanizmat plotësues, kontrollues e nxitës, për një jetësim të plotë të plan-programeve të caktuara sipas prioriteteve, varësisht

prej bibliotekave dhe fazës së saj të zhvillimit.

BKUK, në këtë kontekst arrin të plotësojë një boshllëk, në këtë dimension, me organizimin e Javës së Bibliotekës, e cila organizohet bashkë me Ambasadën e Amerikës në Prishtinë, si dhe të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, që është organizim i përbashkët me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, gjatë së cilës ekspertë ndërkombëtarë dhe bibliotekarë nga Kosova dhe Shqipëria, trajtojnë tema me interes nga fusha e bibliotekarisë, shumë herë këto ligjërata përkohë me probleme që janë të lidhura drejtpërdrejt me ballafaqimet reale të një bibliotekari në procesin e aktivitetet e tij të përditshme në bibliotekë. Këto dy organizime kanë funksionin e institucioneve të veçanta për ta mbajtur stafin bibliotekar te ne të informuar dhe në rrjedha të dijeve në fushë të bibliotekarisë. Kujtojmë këtu se të gjitha ligjëratat e sesioneve të këtyre dy organizimeve mblidhen dhe botohen në botime të veçanta, prej të cilave bibliotekari mund të përfitojë duke i pasur ato në përdorim.

Tani kemi ndryshime të shpejta në botën e informacionit, bibliotekat si institucionet të kulturës mbeten të rëndësishme në arsimin intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Sfidat e ndryshimeve në botën e informacionit, kërkojnë alternativa dhe zgjidhje të shpejta dhe të qëlluara, në mënyrë që të mos grumbullohen problemet. Cilat janë mundësitë tona dhe ku është pasiguria jonë?! Në këtë kontekst na duhet planifikimi i politikave programore dhe i strategjive zhvillimore, që nënkuptojnë një tërësi veprimesh të përbashkëta institucionale dhe këto duhet t'i realizojmë me kohë. Në këtë nguti të zhvillimeve të botës së informacionit, duhet të ngutemi edhe ne. A jemi duke e bërë këtë?!

BIBLIOTEKA E FERIZAJT DHE PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT

MR. TEUTA DEMIRI

Biblioteka në Ferizaj, rifillimin e punës në vitin 1999, e bëri me një përkushtim dhe angazhim të veçantë, që të vihet në shërbim të lexuesve. Shumë shpejt biblioteka avancoi në zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare, duke i zgjeruar sektorët, duke rritur numrin e përdoruesve, si dhe duke pasuruar fondin e librave.

Pas kryerjes së renovimit të Bibliotekës Ndërkomunale “Anton Çetta”, u standardizua funksionaliteti i saj, duke u ofruar kushte të mira përdoruesve. Pra, nën menaxhimin e Ministrisë së Kulturës, bibliotekës iu krijuan mundësi në zhvillimin dhe shtimin e sektorëve, në rritjen e numrit të punëtorëve dhe ç’është më me rëndësi në pasurimin e fondit librar. Krahas kësaj, u organizuan aktivitete të ndryshme kulturore, duke sensibilizuar opinionin për peshën kulturore të bibliotekës.

Më 2001, qyteti i Ferizajt u bë edhe me një bibliotekë - “Public Library”, bibliotekë kjo e financuar nga USAID-i në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt. Kjo bibliotekë ishte e pasuruar kryesisht me fonde në gjuhën angleze nga fusha të ndryshme të dijes, krahas librit në gjuhën shqipe. Me funksionalizimin e këtyre dy bibliotekave, u mundësua që përdorues të moshave dhe fushave të ndryshme, të jenë shfrytëzues të rregullt të bibliotekave, duke plotësuar nevojat e tyre me fondet që ishin në shfrytëzim, si dhe duke iu afuar ambient dhe kushte të rehatshme për punë. Të dy bibliotekat ofronin fond të pasur të koleksioneve nga fusha të ndryshme të shkencave humane dhe atyre ekzakste. Më 2010, Biblioteka Ndërkomunale kaloi nën menaxhimin e Komunës së

Ferizajt dhe me këtë kalim u paraqit propozimi për bashkimin e dy bibliotekave në një emër të vetëm “Sadik Tafarshiku”, në mënyrë që të fitohet edhe më shumë në hapësirë për përdoruesit. Koleksioni për fëmijë mbeti i ndarë për të funksionuar si bibliotekë ekskluzive për fëmijë.

Renovimi dhe riorganizimi i hapësirës së bibliotekës “Sadik Tafarshiku”, si dhe bashkimi i tërë fondit të librave, paraqiti nevojën edhe të një risistemimi të sektorëve, gjë që u realizuar sipas standardeve në etapat në vijim. Tani biblioteka për të rritur funksionon me këta sektorë: Sektori i informatikës, Sektori i periodikut, Sektori i huazimit të librit, Sektori i përpunimit të fondeve, Sallat e leximit dhe Salla për studime të veçanta. Po ashtu, fondi i librave - i ndarë dhe i klasifikuar sipas KUD-it, në hapësira të veçanta të bibliotekës, ka mundësuar përmirësimin dhe funksionalizimin e shërbimeve.

Sipas të dhënave, Biblioteka “Sadik Tafarshiku”, në fondin e saj ka 3565 tituj apo 6491 ekzemplarë. Tani me risistemimin e fondeve, është bërë edhe revizioni i librit dhe kjo shifër është rritur. Biblioteka ka synim që të riinventarizojë të gjitha librat për të ditur numrin e saktë të fondit.

Në funksion të pasurimit të fondeve, biblioteka është angazhuar në sigurimin e donacioneve nga individë dhe institucione. Të kujtojmë se në vitin 2010, biblioteka fitoi një donacion nga Postë-Telekomunikacioni i Kosovës në vlerë prej 9.500 , duke u pasuruar me 829 tituj apo me 2747 ekzemplarë. Ky donacion ishte kryesisht lekturë shkollore, duke pasuruar edhe tri degë të bibliotekës.

Me ndarjen dhe funksionalizimin e sektorëve, është bërë e mundur edhe

radhitja e periodikut dhe sistemimi i tij. Përdoruesit tashmë do të kenë qasje të plotë në këtë fond, të cilin biblioteka e posedon që nga viti 1959, duke e pasuruar me tituj periodikë gjatë fazave të zhvillimit të periodikut në Kosovë.

Gjithashtu, biblioteka, në një hapësirë të veçantë, ka formuar edhe Këndin e Vendlindjes dhe në ardhmen ky kënd do mund të funksionojë edhe si sektor i veçantë brenda bibliotekës.

Modernizimi i shërbimeve ndërli-dhet me fillimin sa më të shpejtë të vënies në funksion të programit Aleph 500, program i cili funksionon në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ky program do të mundësojë përpunimin automatik të koleksioneve, duke lehtësuar shërbimet me qasje online në çdo kohë dhe nga çdo vend. Ky program do të implementohet me përkrahjen financiare të Komunës së Ferizajt.

Në funksion të implementimit të këtij programi, ka filluar trajnimi i stafit të bibliotekës në programin Aleph 500. Trajnimi është duke u bërë nga ekspertë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në fushën e përpunimit dhe të menaxhimit të të dhënave.

Puna profesionale që është duke u bërë në bibliotekë, pasurimi dhe përpunimi i fondeve, organizimi i aktiviteteve me karakter kulturor e informues, si: ekspozita të veprave nga fusha të ndryshme të artit, orë dhe konkurse letrare, takime me shkrimtarë, ekspozita botimesh të reja, promovime të librave etj., janë në funksion të angazhimeve për plotësimin dhe aktivizimin e të gjitha kapaciteteve, në mënyrë që kjo bibliotekë të plotësoj kushtet sipas standardeve më bashkëkohore.

BOTUESIT KUFIZOJNË KOHËN E SHFRYTËZIMIT NË BIBLIOTEKË PËR E-LIBRAT

NGA JULIE BOSMAN

Imagjinoni një libër perfekt. Fletët e tij nuk grisen, kopertinat janë të pathyeshme. Mund të kesh qasje në të nga shtëpia dhe nuk humbet kurrë.

Vlera e këtij libri mrekullisht të përshtatshëm - të njohur ndryshe edhe si e- libra - është subjekt i një debati aktual të furishëm në botën e botimeve. Për shumë vite, bibliotekat publike vepruan pikërisht kështu me koleksionet e tyre; në marrëveshje me botuesit një bibliotekë blen një e-libër i cili mund t'i jepet në shfrytëzim një lexuesi për një kohë, shumë herë, në mënyrë të pakufizuar.

Javën e kaluar, kjo marrëveshje u shkëput nga botuesi HarperCollins kur filluan kufizime të reja për e-librat e tij, duke kërkuar që e-librat e tij të përdoren vetëm 26 herë para se të skadojë afati i marrëveshjes. Kjo nënkupton se dy javë periudhë shikimi/përdorimi janë të mjaftueshme për një libër që të qëndrojë të paktën një vit.

Ajo çfarë mund të ketë qenë një ndërrim i thjeshtë, mezi i vërejtshëm, në këto politika, ka nxitur bibliotekarët në gjithë vendin shumica prej të cilëve rregullat e reja i quajtën të padrejta dhe u zotuan për bojkotim të e-librave të HarperCollins, botues i Doris Lessingut, Sarah Palinit dhe Joyce Carol Oatesit.

"Njerëzit janë të befashuar", tha Anne Silvers Lee, shefja e divizionit të menaxhimit të materialeve në Bibliotekën e Filadelfisë, e cila ka stopuar përkohësisht blerjen e e-librave të Harper Collins. "Ne duam e-libra në



koleksionet tona, klientët tanë na bëjnë me dije se duan e-libra, kështu unë dua që ne të jemi në gjendje të marrim e-libra nga të gjithë botuesit. Unë gjithashtu kam nevojë ta bëj këtë në një mënyrë që mos të jenë tepër të shtrenjta.

Por disa bibliotekarë thanë se ndryshimi, sado që jo i mirëpritur, ka ndezur debat publik tashmë të vonuar rreth e-librave në biblioteka. Derisa bibliotekarët janë të gatshëm për më shumë e-libra për të plotësuar nevojat e përdoruesve, botuesit, duke parë interesin e tyre, janë duke rishikuar sa e vlefshme do të jetë qasja në e-librat e tyre.

"Njerëzit janë të shqetësuar për shumë arsye të forta", thotë Robert Stevens, president i Asociacionit të Bibliotekave të Amerikës. "Buxhetet e bibliotekave janë, në rastin më të mirë, në stagnim. Përdorimi i e-librave ka qenë i fryrë. Ndërsa çështja tjetër është se ka drojë që ky model mund të përdoret nga botuesit tjerë.

Njësoj si në marketet me shitje me pakicë, pyetja sa mund të kushtoj një

e-libër është larg nga përgjigja. Botuesit kundërshtojnë standardin 9.99 dollarë që Amazon e vuri për shumë e-libra, ndaj pranverën e kaluar, disa botues të mëdhenj përvetësuan modelin që u lejon atyre të vendosin çmimet e tyre.

Këtë muaj, Random House, i vetëm në mesin e gjashtë botuesve më të mëdhenj, përfundimisht i është bashkuar modelit të agjencisë. Tani shumë e-libra të sapobotuar kanë çmime prej 12.99 deri 14.99 dollarë derisa titujt në zbritje rregullisht janë nën 2.99 dollarë.

HarperCollins, duke mbrojtur veten, vuri në dukje se politika e tij për bibliotekat është e vjetër një dekadë, e bërë para se e-librat të ishin popullarizuar ashtu si janë sot. Politika e re aplikohet në sigurimin e librave të rinj. "Ne kemi probleme serioze me politikën e mëparshme për e-librat me të cilën ne u shisnim e-libra bibliotekave në vazhdimësi. Nëse ajo do të mbetet e pandryshuar, do ta minonte shfaqjen e ekosistemit të e-librave, do ta lëndonte rrjedhën e rritjes të e-librave,

do të shkaktonte presion shtesë mbi libraritë fizike (klasike) dhe, fundja, do të çonte në rënie të shitjes së librit dhe honorarëve për autorë”, thuhet në deklaratën e kompanisë.

Duket akoma një befasi për shumë konsumator që e-librat janë në dispozicion në biblioteka. Veçanërisht në këto vitet e fundit, bibliotekat kanë zgjeruar koleksionet e tyre të e-librave, shpeshherë përmes Over Drive, një ofrues i madh i e-librave për bibliotekat publike dhe ato shkollore. Sipas Asociacionit të Bibliotekave të Amerikës, në planin mbarëkombëtar, 66 për qind e bibliotekave publike ofrojnë e-libra pa pagesë për abonentët e tyre.

Për shumë bibliotekarë, interesimi i abonuesve të cilët duan të marrin e-libra ka qenë marramendës. Në Bibliotekën Publike të New Yorkut, përdorimi i e-librave është 36 për qind më i lartë se sa që ishte vetëm një vit më parë. Sipas disa bibliotekarëve, kërkesa ka pasur veçanërisht nga dhjetori, sepse e-lexuesit ishin dhurata popullore për festa.

“Sikur që leximi ynë bëhet online, edhe dollarët tanë materialë shkojnë online”, thotë Christofer Platt, drejtor i qarkullimit dhe koleksioneve për Bibliotekën Publike të New Yorkut.

Sa i përket huazimit, e-librat janë trajtuar më shumë si libra të printuar. Ata janë në dispozicion në mënyrë tipike për një përdorues në një kohë të caktuar, shpesh për një periudhë 7 deri në 14 ditë. Por, ndryshe nga librat e printuar, përdoruesit nuk kanë nevojë ta frekuentojnë fizikisht bibliotekën për t'i marrë ata - e-librat mund të shkarkohen nga shtëpia, në mobil, kompjuter personal dhe e-lexuesit, përfshirë edhe Nooks-ët, lexuesit Sony, laptopët dhe smartfonët. (E-librat e bibliotekës nuk mund të lexohen në e-lexuesin e Amazon Kindle). Me përfundimin e periudhës së për-



dorimit, e-libri në mënyrë automatike skadon nga llogaria e huazuesit.

Lehtësia me të cilën e-libri mund të huazohet nga biblioteka, në mënyrë potenciale i kthen blerësit e e-librave në huazues të e-librave dhe kjo i bën disa botues të mos ndihen mirë. Simon & Schuster dhe Macmillan, dy nga botuesit më të mëdhenj në Shtetet e Bashkuara, nuk i kanë e-librat e tyre në dispozicion fare në biblioteka.

“Ne jemi duke punuar me zell në përpjekje për të krijuar kushte që do të kënaqin nevojat e bibliotekave dhe mbrojnë vlerat e pronës intelektuale”, thotë në një e-mail John Sargent, shef ekzekutiv i Macmillan. “Kur ne të përcaktojmë këto kushte, ne do të shesim e-libra për bibliotekat, çfarë aktualisht nuk e bëjmë.”

Ndërsa botuesit që i kanë në dispozicion e-librat e tyre në biblioteka thonë që marrëveshjet e tanishme për çmime kane nevojë të përmirësohen.

Random House për shembull nuk ka plane të menjëhershme për të ndryshuar kushtet e marrëveshjeve me bibliotekat, thotë Stuart Applebaum, zëdhënës i botuesit, por nuk e përzjash-ton këtë në të ardhmen.

“Çfarëdo që ne do të bëjmë në të ardhmen, gjithsesi ne duam të flasim me komunitetin dhe së bashku të kuptojmë çfarë ka kuptim për të dy palët”, thotë z. Applebaum. “Ne jemi të hapur

për ndryshime në të ardhmen të cilat janë në hap me pritjet dhe realitetet e gjithë komunitetit bibliotekar”.

Botuesit janë të nervozuar për shkak se huazimi i e-librave në biblioteka do t'i egërsojë shitësit me pakicë. Ata po ashtu pësojnë humbje në të ardhurat vjetore kur bibliotekat zëvendësojnë librat e dëmtuar ose edicionet me lidhje të fortë me edicione me lidhje të butë. Shitja për bibliotekat llogaritet prej 7-9 për qind të të ardhurave të përgjithshme vjetore, thonë dy botuesit më të mëdhenj.

Por e-librat kanë edhe anën tjetër të tyre, gjithashtu. Shumë biblioteka spastrohen nga librat e palexuar në formë të printuar përmes tregut të librave të përdorur, një burim i të ardhurave që e-librat e palexuar nuk mund ta sigurojnë.

Asociacioni i Bibliotekave të Amerikës ka themeluar dy taskforca për të studiuar këtë çështje.

Edhe në mesin e bibliotekarëve që kanë ndaluar blerjen e e-librave nga HarperCollins, ka të tillë që thonë se duhet të ketë një kompromis.

“Unë mund të shoh anët e kësaj çështjeje”, thotë Lisa Sampley, menaxhere e sektorit të koleksioneve në bibliotekën Springfield-Greene të Distriktit në Springfield. “Unë po shpresoj se nëse botuesit e tjerë provojnë të ndryshojnë këtë model ata do të mëndojnë për bibliotekat dhe sa do të na godasë kjo neve. Por unë jam e sigurt se ekziston ndonjë model i cili do të funksiononte për të dy palët”.

Ky tekst, i botuar më 14 mars 2011, është marrë nga “New York Times”, në ueb-faqen: <http://www.nytimes.com/2011/03/15/business/media/15libraries.html>

Nga anglishtja: Lavdie Rrahmani

LUMTURIA E LIBRIT¹

JORGE LUIS BORGES


... Ndër instrumentet e shumtë të njeriut, më i mahnitshmi, pa dyshim është libri. Instrumentet e tjera janë zgjatim i trupit të tij. Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatim i pamjes; telefoni është zgjatim i zërit; kemi edhe parmendën dhe shpatën, kuptohet zgjatime të krahut. Por libri është diçka tjetër: libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës. Në librin “Qezari dhe Kleopatra”, Bernard Shaw thotë për bibliotekën e Aleksandrisë se ajo është kujtesa e njerëzimit. Por libri ka diçka më tepër. Ai është edhe imagjinata e tij. Sepse a nuk është e kaluara jonë një seri ëndrrash? Ç’ndryshim mund të ketë midis kujtoj ëndrrat dhe kujtoj të kaluarën. I tillë është funksioni që kryen libri. Njëherë kam menduar të shkruaja një histori të librit. Jo për pamjen e tij fizike. Nuk më intereson aspekti fiziku i librave (sidomos i bibliofilëve që e teprojnë), por më interesojnë vlerësimet që janë dhënë për librin. Përpara meje e ka bërë Spengler-i te vepra “Perëndimi i Oksidentit” ku ka ca faqe të mrekullueshme për librin. Duke u shtuar atyre ndonjë vëzhgim timin, unë kam ndërmend të mbetem në ato që thotë Spengler-i. Në lashtësi nuk e kishin kultin e librit si e kemi ne - dhe kjo nuk më befason; ata shihnin te libri një surrogato të fjalës së folur. Shprehja që përdoret shpesh. Scripta manent verba volant, nuk ka kuptimin që fjala është jetëshkurtër, porse që shkrimi ka diçka të ngurosor si vdekja. Në të kundërt, fjala ka diçka të lehtë, flatrore; diçka flatrore e të shenjtë, siç thotë Platoni. Është e çuditshme, por gjithë mësue-

sit e mëdhenj të njerëzimit kanë dhënë mësimet gojore. Le të marrim rastin e parë: Pitagorën. Ne e dimë se ai e zgjodhi me vetëdije që të mos shkruante. Dhe këtë e bëri se nuk donte të ishte i lidhur pas fjalës së shkruar. Me sa duket ai e ndjente shprehjen që më pas do të thuhej edhe në Bibël: shkronja vret, shpirti ngjall. Prandaj Aristoteli nuk flet kurrë për Pitagorën, por për pitagorianët. Për shembull, ai thotë se pitagorianët jepnin mësim besimin, dogmën e kthimit të përjetshëm që Niçe do ta zbulonte shumë më vonë. Domethënë idenë e një kohe ciklike, e cila u hodh poshtë nga Shën Agustini te libri “Qyteti i Zotit”. Shën Agustini duke përdorur një metaforë të shkëlqyer thotë se Kryqi i Krishtit na shpëton nga labirinti qerthullor i stoikëve. Ideja e kohës ciklike ka qenë prekur edhe nga Hume-i, nga Blanqui e nga shumë të tjerë. Pitagora nuk shkroi në mënyrë të vullnetshme. Ai donte që mendimi i tij të jetonte përtej vdekjes së tij trupore, të mbijetonte në mendjen e nxënësve të tij. Nga kjo ka lindur formula që unë duke mos ditur greqisht do ta them latinisht: magister dixit. (e ka thënë mjeshtri). Kjo nuk do të thotë se ata qenë të kushtëzuar pas asaj që kishte thënë mjeshtri, përkundrazi me këtë ata vërtetonin se ishin të lirë të zhvillonin mendimin fillestar të mjeshtrit. Ne nuk e dimë nëse doktrinën e kohës ciklike e ka shpikur Pitagora, por dimë se nxënësit e tij ua mësonin të tjerëve. Pitagora vdiq trupërisht dhe ata me një lloj transmigrimi që atij do t’i kishte pëlqyer, vazhduan t’i mendonin e t’i thellonin idetë e tij, aq sa kur i qortonin se duhej të thoshin gjëra të

reja, mbroheshin me formulën: E ka thënë mjeshtri (Magister dixit). Mund të kujtojmë raste të tjera. Kemi shembullin e madh të Platonit kur thotë se librat janë si efizhitë (ai kishte parasysh mbase statuja apo tablo), që njeriu i pandeh të gjalla, por kur i pyet, ato, s’të përgjigjen. Dhe për ta korigjuar këtë heshtje të librave, ai shpiku dialogun. Pra, Platoni vetë shndërrohet në personazhe të ndryshme: në Sokrat, në Gjorgjia e të tjerë. Mund të na shkojë në mendje edhe se Platoni donte të ngushëllohej për vdekjen e Sokratit, duke e përfytyruar të gjallë. Dhe çfarëdo problemi që t’i dilte, ai pyeste veten: Çfarë do të kishte thënë Sokrati për këtë. Ai qe si të thuash pavdekësia e Sokratit, që s’pati lënë asgjë të shkruar dhe ishte gjithashtu mjeshtër i fjalës së folur. Për Krishtin dimë se ka shkruar një herë të vetme ca fjalë mbi rërë e që u fshinë. Nuk dimë të ketë shkruar gjë tjetër. Edhe Buda ishte mjeshtër i të folurit; na ka lënë disa predikime. Pastaj, kemi edhe një frazë të Shën Anselmit, i cili thotë: “Të vësh një libër në duart e një injoranti, është po aq e rrezikshme sa të vësh një shpatë në duart e një fëmije”. Ja pra se çfarë mendohej atëherë për librin. Në të gjithë Orientin ende gjallon ideja se qëllimi i një libri nuk është t’i zbulojë gjërat: një libër duhet thjesht të na ndihmojë për t’i zbuluar. Me gjithë paditurinë time në hebraisht, e kam studiuar pak Kabbalën dhe kam lexuar versione anglisht e gjermanisht të Zoharit (Libri i Shkëlqimit) dhe të Sefer Jezirasë (Libri i Marrëveshjes). Unë e di se këta libra nuk janë shkruar për t’u kuptuar, por për t’u interpretuar, ata duhet ta nx-

¹ Ligjëratë e mbajtur nga autori me studentët e Universitetit të Belgranos, Buenos-Aires, 1977.

isin lexuesin që të zhvillojë një ide. Antikiteti klasik nuk e kishte respektin që kemi ne për librin edhe pse kemi mësuar se Aleksandri i Madh mbante nën jastëk "Iliadën" dhe shpatën, dy armët e tij. Ushqehej respekt për Homerin, megjithatë ai nuk shihej si shkrimtar i shenjtë, në kuptimin që ka sot kjo fjalë. Nuk mendohej se "Iliada" dhe "Odiseja" ishin tekste të shenjta; ato qenë tekste që vlerësoheshin, por edhe mund t'i kritikojë. Platoni i flaku poetët nga "Republika" e tij; gjithsesi pa u bërë i dyshimtë për herezi. Këtyre dëshmime të antikitetit kundër librit, ne mund t'u shtojmë një tjetër, shumë interesante të Senekës. Mes letrave të tij të pakrahasueshme drejtuar Lucililit, njëra i drejtohet një personi mendjemadh, për të cilin tregon se kishte një bibliotekë me njëqind vëllime; dhe kush - thotë Seneka - mund ta gjejë kohën për të lexuar njëqind vëllime. Ndërsa sot, përkundrazi, çmohen bibliotekat e mëdha. Pra, në antikitet për librin ka një qëndrim që mezi e kuptojmë, që nuk ngjason me kultin që kemi ne për librin. Te ky i fundit shihet përherë një surrogato e fjalës. Por më pas nga Orienti vjen një koncept krejt i panjohur për antikitetin klasik: Koncepti i librit të shenjtë. Do të marrim dy shembuj duke filluar nga më i vonshmi, nga ai i myslimanëve. Ata mendojnë se Kurani i paraprin Krijimit dhe është më i moçëm se gjuha arabe. Kurani, thonë ata, nuk është vepër e Zotit, por njëra prej vetive të tij, siç janë mëshira apo drejtësia. Aty flitet në një mënyrë të pabesueshme për mëmën e librit. Mëma e librit është një kopje e Kuranit të shkruar në qiell. Shkurt, ai është arketipi platonian i Kuranit, dhe ky libër është shkruar në qiell, thotë Kurani - si atribut i Zotit, e për më tepër është më i hershëm se Krijimi. Këtë gjë e thonë edhe ulemat apo doktorët myslimanë. Pastaj ka shembuj të tjerë më pranë nesh, siç janë Bibla ose më konkretisht




Jorge Luis Borges

Torah apo Pentateka. Mendohet se këta libra janë diktuar nga Shpirti i shenjtë. Është interesant fakti që këta libra të autorëve dhe epokave të ndryshme, i lihen një shpirti të vetëm; a nuk thuhet madje në Bibël se shpirti frymon ku të dojë? Hebrejtë patën idenë të bashkonin vepra letrare të periudhave të ndryshme dhe të krijonin me to një libër të vetëm me titull Torah që në greqisht do të thotë Bibël. Këta libra i lihen një autori të vetëm: Shpirtit. E pyetën një ditë shkrimtarin Bernard Shaw nëse besonte që Biblën e kishte shkruar Shpirti i shenjtë. Dhe ai u përgjigj kështu: Çdo libër që ia vlen ta rilexosh, është shkruar nga Shpirti. Ta themi disi më ndryshe. Një libër duhet të shkojë përtej qëllimeve të autorit. Qëllimi i autorit është një gjë e varfër, njerëzore që mund të dështojë, kurse libri është më shumë. Don Kishoti, bie fjala, është më tepër se një satirë e romaneve kalorësiake. Në të vërtetë ai është një tekst absolut, tek i cili asgjë, absolutisht asgjë nuk i lihet rastësisë. Të mendojmë ndërveprimet

e kësaj ideje. Për shembull, nëse unë them: Corrientes aguas, puras, cristalinas, arboles que os estais mirando en el lasverde prado, de fresca sombra lleno. (Ujëra të gjalla me dritë kristali në pemë që shfaqeni ndër pasqyrime, livadh i blertë plot hijeshi e freski), duket qartë se këto tri vargje kanë njëmbëdhjetë rrokje. Kështu ka dashur autori. Është zgjedhje e tij. Por çfarë është kjo, krahasuar me një libër të shkruar nga Shpirti, krahasuar me konceptin e Hyjnisë që zbret në letërsi dhe dikton një libër. Në një libër të këtillë asgjë s'mund të jetë e rastësishme, asgjë, deri edhe zgjedhja e shkronjave duhet ta ketë një arsye. Me këtë logjikë e kuptojmë, përse fillimi i Biblës, Bereshit baraelohim është me B, sepse kjo i përgjigjet fjalës bekoj. Fjala është pra, për një libër, në të cilin kurrë nuk është e rastësishme, absolutisht asgjë. Mbërrijmë kështu te Kabala, te studimi i shkronjave, te një libër i shenjtë i diktuar nga Hyjnia, domethënë në të kundërt të asaj që mendonin të vjetrit. Ata mendonin për muzën në një mënyrë mjaft të

vagëlluar. Këndo, muzë, zemërimin e Akilit, ("Këndo hyjneshë, mërinë e Akil Pelidit", është përkthim i shkëlqyer i Gjon Shllakut, por ky përkthim fjalë për fjalë, me varfëri semantike këtu bëhet, sepse ka një koment lidhur me fjalën muzë. Shën i përkth.) thotë Homeri në krye të Iliadës. Këtu muza përfaqëson frymëzimin. Po të mendojmë Shpirtin, pranojmë diçka më konkrete e më të fuqishme: Zotin që është brenda letërsisë. Zotin që shkruan libër, në të cilin gjithçka arsyetohet: numri i shkronjave, i rrokjeve, i verseteve, ku bëhet lojë fjalësh me shkronja, të cilat tashmë i kemi studiuar. Ideja e dytë e madhe që kemi për librin, është se ai, po e përsëris, mund të jetë vepër hyjnore. Sigurisht kjo ide është më afër asaj që kemi sot për librin se ajo e lashtësisë që e vështron librin si një surrogato të fjalës së folur. Pastaj besimi në një libër të shenjtë humbet dhe zëvendësohet prej besimeve të tjera. Ekziston bindja, për shembull, se çdo vend njëjtësohet me një libër. Duhet të kujtojmë këtu se myslimanët i quajnë izraelitët njerëz të Librit, le të kujtojmë gjithashtu atë që ka thënë Henri Heine në lidhje me kombin, atdheu i të cilit ishte një libër Bibla, çifutët. Dhe lind kështu ideja e re, sipas së cilës çdo vend duhet të përfaqësohet nga një libër, apo nga një autor që mund të ketë shkruar shumë libra. Është e çuditshme - dhe nuk besoj se ky fakt është vënë re deri tani - por vendet kanë zgjedhur individë që nuk u ngjajnë shumë. Dikush, për shembull, mendon se Anglia mund të kishte zgjedhur Samuel Johnson-in, por ajo ka zgjedhur Shekspirin dhe Shekspiri është si të thuash - më pak anglezi ndër shkrimtarët anglezë. "Understatement-i, pra, është karakteri tipik i anglezitet. Por Shekspiri priret ndaj hiperbolës në metaforë dhe nuk do të habiteshim fare nëse ai do të kishte qenë italian apo çifut. Kështu ka ndodhur edhe me Gjermaninë, ky



vend i bukur fanatik për hiçgjë, zgjodhi pikërisht një njeri tolerant, aspak fanatik, të cilit nuk i intereson shumë nocioni atdhe, pra zgjodhi Gëten. Gjermania përfaqësohet nga Gëte. Në Francë nuk është zgjedhur ndonjë, por ka një dobësi për Hygoin. Natyrisht, unë ushqej një admirim të madh për Hygoin, por Hygoi nuk është francez tipik. Hygoi është i huaj për Francën: me dekoret e tij të mëdha e me metaforat e panumërta, ai s'është përfaqësues i Francës. Edhe më i habitshëm është rasti i Spanjës. Ajo mund të përfaqësohet nga Lope De Vega, nga Calderon, nga Quevedo. E pra, jo! Nuk ndodhi ashtu! Spanja përfaqësohet nga Migel de Servantes. Servantesi është bashkëkohës i Inkuizicionit, por është një njeri tolerant që nuk zotëron as virtetet dhe as cenet e spanjollëve. Ngjason sikur çdo vend mendon se duhet të përfaqësohet nga dikush që ndryshon prej tij, nga dikush që mund të jetë si një lloj bari shërues, një lloj opiumi, një kundërhelm ndaj të metave. Ne argentinasit, mund të kishim zgjedhur "Fakundon" e Sarmientos, që është libri

ynë, por jo; me historinë tonë ushtarake, me historinë e betejave, ne kemi zgjedhur si libër kronikën e një dezertori, kemi zgjedhur librin "Martin Fierro", që padyshim meriton të zgjidhet, por si mund të mendohet që historia jonë të përfaqësohet nga një dezertor i pushtimit të tokave? Gjithsesi kështu është: çdo vend duket se provon mbëhinë e kompensimit. Për librin janë shkruar faqe të ndritura nga shumë shkrimtarë. Do të doja të citoja ndonjërin prej tyre. Po e nis me Montenj, i cili një nga esetë e tij ia kush-ton pikërisht librit. Në këtë ese ka një frazë të tillë, të paharrueshme. "Unë nuk bëj asgjë pa gëzim". Montenji lë të kuptohet se koncepti i të lexuarit me çdo kusht, është një koncept i gabuar. Ai thotë se kur has ndonjë pjesë të vështirë në një libër, ai e lë, sepse akti i të lexuarit është një formë e lumturisë. Më kujtohet se para shumë vitesh u bë një anketë ku pyetej se çfarë shpreh piktura. E pyetën motrën time, Norën, dhe ajo u përgjigj se piktura ishte arti që dhuron gëzim me forma dhe ngjyra. Unë do të thosha se edhe letër-

sia është një formë e këtij gëzimi. Nëse diçka lexohet me vështirësi, autori nuk e ka përmbushur misionin e vet. Ja përse unë mendoj se një shkrimtar si Xhojsi në thelb e ka harruar misionin, sepse vepra e tij lyp mundim për ta lexuar. Një libër nuk duhet të kërkojë mundim, sepse lumturia nuk duhet të kërkojë mundim. Më duket se Montenji ka të drejtë. Pas kësaj ai numëron autorët që ka për zemër. Përmend Virgjilin dhe pohon që më shumë pëlqen “Gjeorgjikat” se “Eneidën”. Unë për vete pëlqej “Eneidën”, por s’është këtu çështja. Montenji flet me pasion për librat dhe thotë se librat janë një kënaqësi e ngadaltë... Ndërsa Emersoni thotë të kundërtën. Nga ai e kemi studimin tjetër të madh për librin. Në një nga ligjëratat e tij, Emersoni thotë se biblioteka është një lloj kabineti magjik. Në këtë kabinet rrinë të magjepsur shpirtat më të zgjedhur të njerëzimit, të cilët presin fjalën tonë për të dalë nga heshtja. Duhet ta hapim librin që shpirtat të rizgjojnë. Ai thotë se ne duhet të kemi besim në shoqërinë e njerëzve më të mirë që ka prodhuar njerëzimi, por që ne nuk i kërkojmë dhe na pëlqen më tepër të lexojmë komentare e kritika, në vend që të lexojmë autorët vetë. Për njëzet vjet unë kam qenë profesor i letërsisë angleze në universitet, në fakultetin e filozofisë e të letërsisë në Buenos Aires. Gjithmonë u thosha studentëve të mi që të kishim një bibliografi sa më të seleksionuar, të mos lexonin libra kritike, por drejtpërdrejt autorët; ndoshta do të kuptonin më pak, por do të kishin kënaqësinë të dëgjonin zërin e dikujt. Do të thosha se më i rëndësishëm te një autor është tingulli i zërit (stili, shën. i përkth.), pra më i rëndësishëm te një libër është zëri i autorit, ai zë që arrin të vijë gjer te ne. Unë një pjesë të madhe të jetës në të vërtetë ia kam kushtuar letërsisë, dhe besoj se leximi është një formë e lumturisë; një tjetër formë e lumturisë, më

e pakët, është krijimi poetik, apo ajo çka quhet krijim, që është përzierje e harresës dhe e kujtesës së asaj që kemi lexuar. Emersoni bashkohet me Montenjin kur thotë se duhet lexuar çfarë na pëlqen, sepse siç e thamë libri duhet të jetë një formë e lumturisë. Ne i detyrohemi shumë letërsisë. Unë, më tepër jam i prirë të rilexoj se sa të lexoj dhe kam mendimin, se më e vlefshme është të rilexosh sa të lexosh, duke mos lënë pa përmendur se për të rilexuar duhet të kesh lexuar. Unë e kam këtë kult për librin. Mbase e them në një mënyrë që tingëllon disi patetike, por s’do të doja të ishte kështu. Do më pëlqente të ishte si një lloj besimi që kam për secilin prej jush, jo për të gjithë, sepse të gjithë është abstraksion dhe secili është një realitet. Duke pasur kultin e librit, unë vazhdoj të bëj sikur nuk jam i verbër, vazhdoj të blej libra e të mbush shtëpinë me to. Një ditë më parë më bënë dhuratë një botim të vitit 1966 të Encyclopedie de Brockhaus. Dhe e ndjeva praninë e kësaj veprë në shtëpi, e kam ndjerë si një lloj lumturie. I kisha pranë meje të njëzet vëllimet me shkronja gotike, të cilat nuk mund t’i lexoj, plot harta dhe gravura që nuk mund t’i shoh: por sidoqoftë vepra ishte aty. Provoja një si tërheqje miqësore. Kam mendimin se libri është një nga lumturitë e mundshme të njeriut. Sot flitet për zhdukjen e librit: mua më duket se kjo është e pamundur. Do të më thonë se cili është ndryshimi mes një libri dhe një gazete apo një disku? Ndryshimi është ky: një gazetë lexohet për t’u harruar edhe disku dëgjohehet për t’u harruar, është një gjë mekanike dhe kuptohet që është e përkohshme. Porse një libër lexohet për t’u kujtuar. Koncepti i një libri të shenjtë, si Kurani, si Bibla apo Vedat - që shkruajnë se edhe ato e kanë krijuar botën - është ndoshta i tejkaluar, por libri ruan përherë një shenjtërim, të cilin duhet të përpiqemi të mos e

humbim. Të marrësh një libër e ta hapësh, e bën edhe më të mundshëm faktin estetik. Cilat janë fjalët që flenë në libër? Ç’janë ato simbole të vdekura? Krejtësisht asgjë. Çfarë është një libër që nuk e hapim? Është thjesht një kub letre apo lëkure, me fletë; por nëse e lexojmë do të ndodhë diçka e çuditshme. Dhe besoj se libri ndryshon sa herë që e lexojmë. Herakliti thotë (e kam përsëritur shpesh) se njeriu kurrë nuk lahet dy herë në të njëjtin lumë. Ne nuk lahem kurrë në të njëjtin lumë, sepse ujërat e tij ndërrojnë. Akoma më e tmerrshme është se edhe ne jemi ujqorë si lumi. Sa herë që lexojmë një libër, aq herë ndryshon ai, ngjyrimi i fjalëve nuk është i njëjlojtë. Sepse librat janë mbrujtur me të shkuar. Kam folur kundër kritikës dhe po e përgënjeshtroj veten (ç’rëndësi ka që përgënjeshtrohem?). Hamleti nuk është saktësisht ai Hamlet që krijoi Shekspiri në fillimet e shek. XVII; Hamleti është Hamleti për të cilin flet Kollrixhi, Gëteja dhe Bredli. Hamleti është rikrijuar. E njëjta gjë ka ndodhur me Don Kishotin. Kjo mund të thuhet edhe për Lugones apo Martinez Estrada. “Martin Fierro” nuk është më ai që ka qenë. Lexuesit pak nga pak e kanë pasuruar librin. Kur lexojmë një libër të hershëm, është një lloj si të përshkonim kohën që ka kaluar që nga çastet kur ai është shkruar e deri në ditët tona. Ja përse duhet të kemi kultin e librit. Një libër mund të jetë plot gabime shtypi, ndodh edhe që të mos jemi dakord me atë që thotë autori, por libri ka diçka të shenjtë dhe hyjnore. Nuk duhet ta respektojmë atë, të shtyrë nga besëtytnia, por me dëshirën e madhërishtme që të kridhemi në lumturi e në dije. Kjo është ajo që doja t’ju thosha sot.

Nga frëngjishtja:
FERIDE PAPLEKA

VITA CON SIDERE¹

(NJË FILM PËR BIBLIOTEKËN DHE FILOZOFINË)
 “AGORA”, 2009, REGJIA: ALEJANDRO AMENABAR

ARSIM CANOLLI

Paradigmat e historisë dhe filozofisë politike shpesh na japin të kuptojmë se në kohët e tensioneve politike e religjioze, filozofia - si dashuri për dije, mund të tkurret në vete dhe të humb peshë ose, në anën tjetër, një ‘hanë’ e saj mund të bëhet vegël e një ideologjie dhe frymon në spektrin e saj. Sidoqoftë, këto paradigma mjaftojnë vetëm sa për të pohuar një mendim, e jo për të argumentuar - e lëre më sheshuar, peshën e filozofisë gjatë historisë. Mirëpo, po të donim të dinim më shumë rreth mbijetesës së filozofisë gjatë periudhave të tensioneve të ndryshme, atëherë do të mund të niseshim me faktin më bazik se filozofia është dashuri për dije, dashuri për të njohur relacionet harmonike në atë që e quajmë realitet i pavarur nga mendja dhe dashuri për të njohur relacionet e njeriut me atë realitet. Andaj, mund të themi se filozofia si dashuri për dijen dhe urtinë, ndonëse mund të tkurret dhe të humbë peshë në kohë të pakohë, mban gjallë moralin e saj falë ngushëllimit që gjen në Bibliotekë. Biblioteka është vendi që e ruan dhe e zhvillon filozofinë vetëm për të ruajtur sa më mirë e zhvilluar sa më shumë dashurinë për jetën: dashuri kjo që në Bibliotekë mbahet edhe e shkruar në letër. Herë pas here, secili nga ne ka qenë lexues i romaneve, historiografive e filmave për Bibliotekën. Nëpërmes tyre kemi

marrë njohuri për Bibliotekën si institucion dhe zhvillimin e saj gjatë historisë. Megjithatë, rrallë na është falur ndonjë vepër që e afirmon bukurinë e vërtetë të saj. Megjithatë, vlen të përmendet një film i fundit për Bibliotekën dhe shpirtin që e mban gjallë atë. Ky është filmi *Agora* (2009), i regjisorit të mirënjohur spanjoll Alejandro Amenabar. Pa dyshim, do të mund të themi se ky film është “Filmi për Bibliotekën”.


Agora na sjell në skenën kinematografike tregimin për Bibliotekën e Aleksandrisë dhe shpirtin që e mban gjallë atë, shpirtin e filozofit që dashuron dhe i beson dashurisë për dije. Në këtë film kamera merr në sy personazhin kryesor - Ipatia, që, si filozofe dhe mësuese në Bibliotekë, gjakon deshifrimin e “harmonisë së yjeve në qiell”, të cilëve nuk ua ndan sytë e nuk i lëshon nga mendja. Tema e filmit ndërtohet rreth Bibliotekës së Aleksandrisë së viteve 600 pas Krishtit (pjesës së mbetur nga shkatërrimi i së parës) dhe ngjarjeve të mëdha të asaj kohe, të cilat shkaktuar djegien e shkrimeve të saj. Krahas Ipatisë, kemi edhe dy personazhe: Oresti - student i saj pagan, i cili më vonë, si i konvertuar në krishterë, arrin të bëhet prefekt romak i qytetit, dhe tjetri, Davus, skllav i saj i krishterë, më vonë pjesëtar i një grupi të quajtur *Parabolani*, që bën shërbime të ndryshme për klerikët e krishterë.

Filmi hapet duke treguar dashurinë mes trinisë Ipatia-Oresti-Davus dhe abstenimin që Ipatia bën ndaj

dashurisë së Orestit. Fabula e filmit vazhdon me shfaqjen e një konflikti mes paganëve (pjesëtarë të të cilëve ishin Ipatia dhe Oresti), që ishin pjesa sundimtare, dhe të krishterëve, që bëheshim më agresivë hera-herës. Ky konflikt kulmon në shkatërrimin dhe djegien e shkrimeve të bibliotekës së Aleksandrisë, e cila posedonte “krejt çka ka mbetur nga dija e urtia e njeriut”, siç na thotë një nga personazhet e filmit. Regjisori arrin që të na paraqesë tmerrin e shkatërrimit të kësaj dije e urtie nëpërmjet një skenografie të përputhshme dhe në funksion të idesë, ku kamera është e vetëdijshme se po ndodh një akt imoral që është kundër parimit filozofik: “ruaj dhe mbroj lirinë akademike” dhe po ashtu na bën të ndjejmë se kamera (alias: ndërgjegjja liberale) e vrojton me pezëm dhe me dhimbje këtë shkatërrim.

Pas kësaj katarze të filmit, ngjarja, në përgjithësi, vazhdon të fokusohet në personazhin e Ipatisë, si filozofe dhe shkencëtare e dhënë plotësisht pas gjetjes së enigmës së rrotullimit të planetëve, duke dyshuar në sistemin e Ptolemeut se toka është në qendër të sistemit tonë diellor. Filmi rrëfen edhe për pasionin e procesit zbulues, për llahtarinë e filozofit me zbulimin e misterit, për “momentin e harmonisë” shpirtërore e racionale kur “të shfaqet” natyra *cogitossë* shëndoshë. Ajo zbulon se nuk është vetëm rrethi, ajo figura e përsosur dhe e pakontestueshme e gjeometrisë euklidiane, e vetmja figurë

¹ Të jetosh me yjet



që shpjegon rrotullimet e planetëve. Duke bërë prova empirike, krahas mendimit racional matematik, dhe duke pasur shpirt të lirë e kureshtar, ajo gjen se Toka është një “endacak” që sillet rreth diellit në elipsë. Andaj, tregimi për Bibliotekën e Aleksandrisë graviton rreth personazhit të Ipatisë - si simbol i mëvetësisë së shpirtit kureshtar, i cili ka filluar qysh me Talesin e Greqisë antike që thuhet se ra në bunar duke mos parë se ku po shkelte, sepse ishte në gjendjen *con sidere* (shprehje romake që përafërsisht do të thotë “sy më sy me yjet”, “duke qëndruar me yjet”). Dihet se kureshtja talesiane i ka dhënë frymë kërkimit teorik qysh atëbotë dhe këtë mendim gjithmonë e ka përkrahur kërkesa *considerale*, herë më shumë e herë më pak gjatë historisë së ideve. Ipatia, e cila akuzohet nga peshkopi i qytetit se është shtrigë pagane, dhe nga anëtarët e asamblesë qeverisëse të qytetit - për ateizëm, deklaroi: “Unë besoj në filozofi!”.

Filmi përfundon me vdekjen e saj, përkatësisht vrasjen të cilën ajo e pranon nga skllavi saj, që nuk duron ta mbysin parabolat, duke e gjuajtur me gurë, por ia merr frymën me dorë të vet. As skllavi as Orestu nuk

mohojnë dashurinë dhe admirimin që kanë për çiltërsinë e saj, edhe pse Ipatia kishte refuzuar të jetë dashnore e Orestit, i cili e donte dhe i besonte, gjë për të cilën ishte akuzuar nga klerikët e krishterë. Ajo po ashtu refuzon të pagëzohet si e krishterë. Ajo nuk do të jetë *con religare* as *con maritus*, por dëshiron të jetojë *con sidere*. Ajo është një çupë e çiltër, e pa përshkruar nga projektet ideologjike e pushtetvënësë; ajo rronte duke soditur yjet dhe duke dashur ta njoh harmoninë dhe vetëm “pushtetin” e tyre. Edhe në momentin saj të vdekjes, ajo mbyll sytë duke parë qiellin përmes një prerje elipsore të çatisë së Bibliotekës, vendit ku pranon të vdesë nga dora e skllavit të saj, të cilin ajo e kishte liruar më herët nga skllavëria. Në këtë pikë narrative mbaron filmi për Bibliotekën.

Pas premierave nëpër botë, ky film ka pasur kritika se është film që sulmon krishterimin. Po ashtu, ka pasur disa kritikë që e kanë vlerësuar si film qëllimor, që, sikur shumë filma të tjerë të kohëve të fundit, rrëfen për fanatizmin religjioz të 1600-viteve më parë, për të na treguar diçka rreth fanatizmit religjioz të sotëm. Sado që disa nga argumentet e këtyre kritikave kanë peshën e tyre, konsideroj se ajo që

brufullon nga ky film është afirmimi kinematografik që i jep mendimit se filozofia e pastër ka vendin e saj brenda Bibliotekës, vendit ku “vdesin” ata që kanë jetuar *con sidere*. Biblioteka është e ndarë nga *polis*-i apo sheshi *agora* ku ndeshen ideologjitë, pushtetet dhe bindjet religjioze. Në një nga fjalët, me njërin nga studentët e saj, i cili tani ishte bërë klerik dhe, përveç respektit dhe dashurisë, donte që kjo të përqafonte krishterimin, Ipatia refuzon, duke thënë atij: “ju nuk e vëni në mëdyshje atë në të cilën besoni... e mua më duhet ta bëj këtë gjë!”. Pra, kjo filozofe, që vë në pikëpyetje gjithçka për të kultivuar traditën filozofike talesiane, është shpirti i asaj që e quajmë Bibliotekë. Ne dimë se gjatë historisë bibliotekat e arkivat e ndryshëm kanë shërbyer për qëllime të ndryshme dhe shpesh edhe ideologjike. Po ashtu dimë se ato kanë refuzuar ideologjitë. Por, ajo që edhe sot e quajmë liri akademike ka dalë nga parimi bazë: *vita con sidere*. Andaj, filmi *Agora* është edhe një vepër që na afirmon mendimin se filozofia (dashuria për dije) dhe Biblioteka, si vend i saj, do të mbijetojnë përkundër çdo ngufatjeje të një periudhe të caktuar kohore.

SPECIFIKAT E AMBIENTIT PËR RUAJTJEN E MATERIALEVE BIBLIOTEKARE

BEDRIJE MEKOLLI

Librat, letrat dhe njësitë e tjera në koleksionet bibliotekare janë të përbëra nga një mori materialesh organike, të cilat janë të ndjeshme në ndryshimet e kushteve të ambientit. Si rrjedhojë, jetëgjatësia e këtyre materialeve është e përcaktuar nga karakteristikat e brendshme të këtyre përbërësve dhe mjedisi në të cilin ato ruhen. Për më tepër, shumë letra të prodhuara nga mesi i shekullit XIX, kanë qenë të përgatitura nga proceset të cilat lënë përbërës të dëmshëm në letër, duke e zvogëluar kështu mundësinë e përdorimit të saj për kohë të gjatë, përkatësisht, duke shkaktuar prishjen e tyre.

Prishjet ndodhin ngadalë, për një periudhë të gjatë kohore dhe nuk vërehen menjëherë, por në rast se ndodhin, ato shpesh janë të pakthyeshme.

Ekzistojnë një numër i 'kontribuesve' të tjerë në prishjen e koleksioneve, të cilët mund të emërtohen si faktorë të jashtëm të prishjes. Ata përfshijnë, trajtimin fizik, vjedhjet, vandalizmat, zjarrin, ujin, insektet, ndotësit, dritën, si dhe, gjithashtu, moskontrollimin e temperaturës dhe lagështisë relative. Në mënyrë të pavarur, secili nga këta faktorë mund të shkaktojë forma specifike të dëmtimeve në koleksionet bibliotekare, por ato gjithashtu veprojnë së bashku.

Ne mund të mos jemi të aftë të ndikojmë në faktorët e brendshëm, por mund të ngadalësojmë shkallën e prishjes dhe/ose mënjanojmë dëmet, me kontrollimin e faktorëve të jashtëm të ambientit.



Metoda më e thjeshtë dhe që bie në sy më së shumti është mirëmbajtja e mirë, si dhe duke zgjedh vendin e ruajtjes, në të cilin minimizohet ekspozimi i materialeve, kushteve të papërshtatshme. Në përgjithësi kushtet e ambientit në të gjitha hapësirat ku ruhen dhe përdoren koleksionet duhen të jenë stabile, nuk duhet të jenë tepër të ngroha, apo tepër të thata dhe tepër të lagështa.

Faktorët e ambientit të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në dëmtimet e materialeve bibliotekare janë temperatura, lagështia relative dhe drita .

TEMPERATURA DHE LAGËSHITIA RELATIVE

Temperatura është një masë standarde e përdorur për të përcaktuar shkallën e nxehtësisë ose ftohtësisë në një ambient, derisa lagështia relative tregon përqindjen e lagështisë në ajrin përkatës në atë temperaturë.

Mbajtja konstante e temperaturës dhe lagështisë relative është një faktor

jetësor në ruajtjen e koleksioneve. Ngase luhatjet e shpeshta të kushteve të ambientit, shkaktojnë dëmtime të pariparueshme në koleksione.

Në kushtet me temperaturë dhe lagështi relative të lartë, fijet e celulozës në letër dhe materiale tjera bibliotekare e absorbojnë lagështinë e tepërt në ajër, duke stimuluar reaksione kimike të bazave ujore të cilat prodhojnë acide, shpejtojnë oksidimin, dhe nxisin rritjen e mykut. Letrat dhe materialet tjera të ekspozuara në këto kushte bëhen të dobëta, me myk dhe njolla.

Ndërkaq nivelet e ulëta të temperaturës dhe lagështisë relative, nxisin fibrat e celulozës të lirojnë avullin e ujit, i cili shkakton prishjen fizike të fibrave. Letra e ekspozuar në kushte të tilla bëhet e thyeshme dhe me ngjyrë të errët.

Nivelet e rekomanduara për ruajtjen e materialeve bibliotekare cilësohen temperatura prej 20° - 21°C, dhe lagështia relative 50%. Temperatura prej 20° - 21°C është një kompromis mes asaj çka është e



DRITA

Drita është një shkaktar i zakonshëm i dëmtimeve të koleksioneve. Si një burim i energjisë, ajo prodhon nxehtësi e cila përshpejton dhe nxit reaksionet kimike, të cilat shpejtojnë prishjet e koleksioneve bibliotekare. Fatkeqësisht, reaksionet vazhdojnë edhe nëse burimi i dritës largohet, megjithëse në një shkallë më të ngadalshme. Kjo lë të kuptohet se çfarëdo ekspozimi në dritë, bile edhe për kohë të shkurtër është i dëmshëm, dhe dëmtimi është pakthyesëm dhe është grumbullues. Sidoqoftë, ekspozimi i zgjatur dhe në niveleve të larta, shkakton dëme të shumta në libra, dokumente dhe koleksionet tjera.

përshtatshme për njerëz dhe e dëshirueshme për materialet. Megjithatë, shumica e materialeve bibliotekare i janë përshtatur më mirë temperaturave më të ulëta, sepse dëmtimet ngjajnë shumë më shpejt në temperatura të larta sesa në ato të ulëta. Ekspozimi në të nxehtë në mënyrë drastike e përshpejton plakjen e materialeve organike.

Materialet organike absorbojnë ose lirojnë lagështinë vazhdimisht, për të arritur ekuilibrin me atmosferën. Ato ngushtohen ose zgjerohen varësisht nga nivelet e lagështisë së ambientit ku ato mbahen. Këto materiale janë më shumë stabile në lagështi relative mesatare 45- 55%. Lagështia relative mbi 68% shkakton fryrjen dhe shtrembërimin e fibrave të letrës dhe përshpejton aciditetin. Gjithashtu lagështia e madhe në prezencë të pjesëve të metalit siç janë kapëset metalike, shkakton njolla ndryshku. Lagështia relative më e vogël se 40% do ta shkakton tharjen e letrës, ashtu që materialet tkurren, plasariten dhe bëhen të brishta, gjithashtu shkakton çngjyrosjen, njolla të pazakonta, rrudha dhe deformime, disa nga të cilat janë në rrezik të dëmtimeve të përhershme. Dëmtime serioze mund të ndodhin kur materialet i janë nënshtruar ndryshimeve të shpejta të lagështisë relative brenda një periudhë të shkurt kohore.

Dëmtimet e dritës manifestohen në shumë mënyra. Drita mund të shkakton letrën të zbardhet, zverdhet, venitet ose errësohet. Ajo mund t'i dobësoi dhe t'i bëjë të thyeshme fibrat e celulozës që e përbejnë letrën. Gjithashtu shkakton zbehje të ngjyrës së shkrimit dhe pigmenteve dhe mund të kontribuoi në vjetrimin, brishtësinë si dhe dëmtimin e shpejt të letrës, pëlhurës, lëkurës etj. Venitja, ndryshimi i ngjyrës, brishtësia, plasaritja, ose ndarja e fletëve, të gjitha janë rezultat i vjetrimin të shpejtuar që është shkaktuar nga drita. Andaj, në hapësirat bibliotekare të shfrytëzuara nga përdoruesit dhe stafi, ndriçimi duhet të jetë i përshtatshëm për lexim dhe punë të rehatshme, por drita duhet të ndalet gjithmonë kur hapësira nuk është në përdorim. Pra, është e domosdoshme që drita të mbahet në minimum, ashtu që shumë pak dritë t'i arrijë koleksionet.

Nëse një koleksion do të ruhet ose jo për të ardhmen është më së shumti e varur nga mënyra e ruajtjes që i ofrohet atij. Duke iu siguruar ruajtje sa më të mirë të mundshme, ne marrim hapin e parë dhe më të rëndësishëm, drejt ruajtjes së trashëgimisë sonë kulturore.



BIBLIOTEKA SPECIALE DHE PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

MR. LUMNIJE KASA

(Biblioteka Ndërkomunale - Mitrovicë)

Personat me nevoja të veçanta janë kategoria ma e ndjeshme e shoqërisë, e cila ka nevojë për ndihmë në fushën e edukimit dhe arsimimit. Prandaj, është përgjegjësi jona për të ndihmuar këtë kategori të personave, në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës dhe kontribuues në të gjitha fushat dhe institucionet ku mund dhe janë të angazhuar.

Në Kosovë, ekziston një numër jo i vogël i kësaj kategorie për të cilët shteti ynë duhet të tregojë një interesim të veçantë. Kjo kategori e personave ka nevojë permanente për mësim, edukim dhe aftësim për punë. Në kuadër të kësaj, në shumë qytete të Kosovës ekzistojnë shkolla speciale, të cilat duhet t'i plotësojnë nevojat dhe standardet, në përputhje me kushtet e parapara që nevojiten për persona me nevoja të veçanta.

Gjatë vizitës këtyre shkollave, vërehet se as objektet e as inventari i tyre nuk u përshtatet kriterëve për personat me nevoja të veçanta. Në shumicën e këtyre shkollave mungojnë bibliotekat shkollore, që do të plotësonin nevojat për këtë kategori të shoqërisë. Kjo shtron domosdonë që, mbështetur në obligimet dhe përgjegjësitë tona në fushën e zhvillimit dhe menaxhimit të bibliotekave, të ofrojmë kushte sa me të mira për ta. Këtu kam parasysh zhvillimin e bibliotekave speciale në kuadër të shkollave për personat me nevoja të veçanta, por, gjithashtu, edhe krijimin e kushteve dhe hapësirave speciale për këtë komunitet në bibliotekat publike të qyteteve tona.

Pra, bibliotekat duhet të krijojnë kushte, varësisht nga kategoria e per-

sonave me nevoja të veçanta, si: kufizimi në të folur, kufizimi në të dëgjuar, kufizimi në ecje etj.

Sigurisht që është me interes të dihet se si do të dukej objekti bibliotekar apo ndonjë kënd në bibliotekat publike dedikuar këtyre personave.

Hapësirat të cilat i përdor kjo kategori e personave, mundësisht duhet të jenë në katin përdhes, me qëllim të lëvizjes sa më të lehtë dhe të sigurt. Në kushte të veçanta, edhe inventari në këto objekte duhet të jetë i përshtatshëm për këtë kategori të personave; të jetë tërheqës, me ngjyra të lehta dhe të llojlojshme dhe i lehtë në përdorim, duke qenë, gjithashtu, i ndërtuar nga materialet e buta me qëllim që të mos ekzistojë mundësi për lëndim të personave me nevoja të veçanta.

Personeli, i cili do të punonte me persona me nevoja të veçanta, duhet të jetë profesionalisht i përgatitur t'u përshtatet llojeve të aktiviteteve dhe nevojave të këtyre personave: të ketë aftësi dhe njohuri komunikimi me personat shurdhëmecë, nëpërmjet gjuhës së shenjave, kufizimit në shikim, alfabetit të brailit; të ketë përkushtim për punën, duke përdorur të gjitha mundësitë arsimore dhe humane. Personeli duhet të dijë të bëjë përzgjedhjen e materialit bibliotekar dhe të jetë tërheqës, me qëllim të përshtatjes së sjelljeve dhe komunikimit karshi personave me nevoja të veçanta.

Materiali bibliotekar, i cili përdoret në biblioteka që u dedikohen personave me nevoja të veçanta, duhet të jetë specifik dhe tërheqës; të jetë edukativ dhe në përputhje me qëllimet dhe objektivat mësimore për këta persona, në mënyrë që sa më lehtë të kuptohen dhe të përvetësohen njohurit në përputhje me plan-programet shkollore. Këtu mund të hyjnë:

tekste ilustruese, libra me tekste të qarta dhe simbole, foto që tregojnë ngjarje, libra të lehtë për lexim, libra me gjuhën e shenjave - për kufizim në të folur dhe dëgjim, libra me shkronja të brailit - për kufizim në shikim, atlase ilustruese - biologjik, gjeografik, zoologjik etj.

Libra me përralla dhe lodra të ndryshme që personifikojnë njerëz dhe shtazë nga jeta e përditshme. Gjithashtu mund të përdoret edhe materiali elektronik, i cili është shumë tërheqës për këta persona, si: CD, audio dhe video kaseta, TV etj.

Që këto institucione të jenë të pajisura me këto mjete specifike dhe të veçanta, duhet ndihma financiare. Këto institucione, me buxhetin e tyre, nuk mund t'i mbulojnë as kërkesat më elementare për plotësimin e këtyre nevojave. Ky buxhet duhet të plotësohet me burime shtesë nga buxheti shtetëror, donacione nga organizata të ndryshme qeveritare e joqeveritare, sponsorë të ndryshëm etj.

Personat me nevoja të veçanta janë të mbrojtur me legjislacion ndërkombëtar, si: Deklarata në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Marrëveshjet Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, Konventa mbi të Drejtat e Personave me nevoja të veçanta etj. Atyre u garantohen këto liri, prandaj duhet t'i gëzojnë plotësisht - pa diskriminim.

Organizata ndërkombëtare të ndryshme, si: UNICEF, UNESCO, IFLA etj., edhe sot sjellin parime e aprovojnë konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e këtyre personave në shkollim, edukim dhe punësim, duke u garantuar të drejta në shkollim, aftësim dhe inkuadrim sa më të lehtë në aktivitete dhe veprimtari që ata janë të gatshëm t'i kryejnë.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË KREMTOI 90-VJETORIN E THEMELIMIT

Tiranë, 24 janar

Në Tiranë, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë u organizua ceremonia përmbyllëse e kremtimit të 90-vjetorit të themelimit të institucionit kryesor bibliotekar të Shqipërisë.

Me pjesëmarrjen e personaliteteve më të njohura shtetërore të Shqipërisë, në mesin e të cilëve ishte i pranishëm edhe kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha, ministra, ambasadorë, shkrimtarë, botues, përfaqësues të jetës akademike etj., u bë përrurimi i bibliografisë së librit shqip, e cila përfshin afër pesë shekuj, nga viti 1555 deri 1944.

Kjo bibliografi përbën njërin ndër projektet më madhore të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe më të drejtë është cilësuar ngjarje historike për gjithë botën kulturore shqiptare.

Për botimet “Libri Shqip 1555-1912” (vëllimi I) dhe “Bibliografi e Librit Shqip 1913-1944” (vëllimi II), kumtesat e tyre



Dr. Sali Bashota pranon medalje të veçantë nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

i paraqitën Nevila Nika, drejtoreshë e Arkivit të Shtetit dhe Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Gjithashtu, u hap edhe ekspozita “Naim Frashëri: një aventurë editoriale 1882-1912”.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Aurel Plasari nderoi me medalje të veçanta “90 vjet Bibliotekë Kombëtare”, në të cilat janë të gdhendura fjalët e Naim Frashërit: “Njerinë e ka bërë njeri të mbaruarë gjuha dhe shkronjat. Këto janë të parat’ e mbrothësisë”.

Këto medalje të mirënjohjes u krijuan për herë të parë dhe posaçërisht me rastin e këtij përvjetori. Në këtë ceremoni solemne, u nderuan personalitete të jetës politike dhe kulturore: Sali Berisha, kryeministër i Shqipërisë, Ferdinand Xhaferaj, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Flavia Tibalini, drejtoreshë e Institutit Italian të Kulturës, Sherif Delvina, anëtar i Këshillit Shkencor të Bibliotekës Kombëtare, Bujar Hudhri, botues i “Onufrit” dhe Farfuri Xhaja, specialiste e bibliotekës.

HI CLASSIC DHUROI KOMplete TË VEPRËS SË I. KADARESË PËR BIBLIOTEKAT E KOSOVËS

Prishtinë, 27 janar

Fondacioni Kulturor Shqiptar HI Classic, i themeluar dhe i drejtuar nga Inva Mula dhe Hetem Ramadani, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, organizoi ceremoninë e shpërndarjes së kompleteve të veprës së plotë të shkrimtarit Ismail Kadare, botuar nga Shtëpia Botuese “Onufri” në Tiranë, dhuratë e këtij fondacioni për bibliotekat e Kosovës.

Nga gjithsej 250 komplete të veprës së këtij shkrimtari, të dhuruara për bibliotekat e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Luginës së Preshevës, Fondacioni Kulturor Shqiptar HI Classic, dhuroi 80 komplete për 50 bibliotekat në Kosovë, duke përfshirë

BKUK, Bibliotekat ndërkomunale, Bibliotekat komunale dhe Biblioteka shkollore.

Drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, duke uruar që nisma të tilla të ketë edhe në të ardhmen, theksoi rëndësinë dhe vlerën e këtij fondi të librave për bibliotekat e Kosovës. Ai njoftoi se drejtuesit e këtij fondacioni tashmë janë Miq të BKUK-së, duke qenë, Fondacioni HI Classic njëri nga donatorët më të rëndësishëm që kanë ndihmuar fondet e bibliotekave në Kosovë.

Sipas përfaqësuesit të këtij fondacionit, Adem Demaçi, kjo dhuratë për bibliotekat është edhe një shenjë se në hapësirat tona bëhen punë të mira që rrisin dhe zgjojnë vetëdijen kulturore kombëtare. Ai foli për rolin e këtij fon-

dacioni dhe për drejtuesit e tij, të cilët vijnë të ndihmojnë dhe afirmojnë kulturën shqiptare në botë. Duke u ndërlidhur me kompletin e veprave të I. Kadesë të botuar nga “Onufri”, dhe të dhuruar për bibliotekat e Kosovës nga HI Classic, theksoi se një shkrimtar kuptohet dhe përjetohet i plotë vetëm kur lexohet në tërësi, e këtë lexim tashmë për lexuesit e Kosovës e mundësoi ky fondacion.

Në përfundim të kësaj ceremonie, drejtori Sali Bashota, me dedikim drejtuesve të Fondacionit Kulturor Shqiptar HI Classic, Inva Mula dhe Hetem Ramadani, i dorëzoi Adem Demaçit falënderimin për këtë fondacion nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË = LIBRARY WEEK IN KOSOVA : 12 – 17 PRILL = APRIL, 2010, PRISHTINË, BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, 2011, 238 F.

Java e Bibliotekës në Kosovë, është botim serik, i teti me radhë, që botohet çdo vit. Në këtë botim jepen punimet e autorëve që kanë referuar gjatë manifestimit Java e Bibliotekës.

Shkrimet janë të strukturuar sipas agjendës së Programit të Javës dhe, po ashtu, sipas formës së prezantimit nga autorët - si ligjëratë me shkrim ose në formë abstrakti.

Ky botim, përfshin ligjëratat e Catherine Marsicek, Zyrtare për burime të informacionit për Austri, vende të Ballkanit, dhe të Kaukazit, në Ambasadën Amerikane në Vjenë, me temën “Trendet e reja në bibliotekarinë amerikane”.

Cikli i ligjëratave për Koleksionet e Veçanta, hapet me referimin e Etleva Domit, zëvendës-drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, ndërsa që vijon me ligjëratat nga bibliotekarë dhe ekspertë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Ky botim, përfshin edhe ligjëratat e sesionit kushtuar jetës dhe veprës së akademik Fehmi Aganit. Nga ky sesion, përfshihen ligjëratat e Akademik Rexhep Ismajli, të zëvendës-ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - dr. Agim Hysenit, si dhe të dr. Mentor Aganit, ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Botimi përfshin edhe ligjëratat nga sesioni për trashëgiminë kulturore të Kosovës, ku kanë referuar drejtori i Arkivit të Kosovës - Jusuf Osmani, kryetarja e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Edi Shukriu, si dhe drejtori i Institutit për Monumenteve Kulturore dhe i Muzeut të Prishtinës - Haxhi Mehmetaj.



THIMI ÇOLLAKU, KALENDARI I BOTËS SHQIPTARE, TIRANË, OMSCA-1, 2010, 542 F.

Në vazhdimin e serisë së botimeve të rëndësishme të shtëpisë botuese OMSCA-1, doli edhe libri “Kalendari i botës shqiptare”. Ky botim është një almanak që padyshim vë në pah ngjarjet më të rëndësishme të botës shqiptare. Kalendari nuk është vetëm sistem i përlogaritjes kohore por edhe kronologji e ngjarjeve të përditshme të jetës së popullit dhe kombit, biografia e tyre shkruhet në vite, shekuj dhe mijëvjeçarë. E parë nga ky pikëshikim, kalendarët më të lashtë në traditën e kulturës shqiptare, janë objektet dhe zbulimet arkeologjike.

Shumica e kalendarëve në gjuhën shqipe pasqyrojnë kronikat historike por edhe festat fetare. “Kalendari i botës shqiptare” përmban ngjarje që nga janari i vitit 1702 e deri në vitin 2006. Në këtë kalendar kujtohen ngjarje historike, politike, kulturore dhe artistike, veprimtari botuese ndër vite, pastaj ngjarje sportive etj. Po ashtu, kujtohen figurat e shkuara dhe copëza ngjarjesh dhe jetësh njerëzore, aktesh madhore dhe zhvillime të thjeshta.

Ky kalendar është pjesë e kujtesës kombëtare, dhe ndihmon në gjetjen e informacioneve më të rëndësishme të historisë dhe kulturës shqiptare.

Pa dyshim se si çdo botim tjetër referal, edhe ky nuk pretendon të jetë shterues në kuptimin gjithëpërfshirës të ngjarjeve, porse përbën një gur në themelet e ndërtimit të vlerave enciklopedike e të dijes mbi informacionin referal për historinë dhe kulturën shqiptare.



BUKURIJE HALITI